

Valbona

BIBLIOTEKA

844-31

K 72

Koçiu



PA MBIEMËR

roman

TIRANE 1993

821.983-31

844-31
K77

VALBONA

KOÇIU

Pa mbiemër

(roman)

52935

SHTËPIA BOTUESE
"NAIM FRASHËRI"

PARATHËNIE

Para shumë vitesh botën letrare franceze e tronditi dalja e romanit "Mirëdita trishtim". Romani që shkruar nga një vajzë maturante, e quajtur Fransuaz Sagan. Ky emër i shfaqur aso kohe për herë të parë mbi një kopertinë libri, do të bëhej më vonë ndër emrat më dominonjës të letrave franceze. Megjithatë edhe dashamirësit më të mëdhej të shkrimtarës, do të venë re se libri i parë i shkruar në moshën 18 vjeçare, do të jetë edhe libri më i mirë i Saganit. Falë spontanitetit, brishtësisë së ndjenjave, guximit për të shkruar jashtë çdo trafiku estetik dhe stilistik. Ndoshta, ndoshta...

Po kështu, katër vite më parë, në Itali, një vajzë maturante botoi romanin e vet të parë, të quajtur "Dëshëroja të kisha pantollona". Një libër ky që krijoi një zhurmë të jashtëzakonshme në botën e qetë të akademikëve e të kritikës së letrave. Dikush kish goditur me gurë xhamin e dritareve të mbyllura të botës letrare, e ky dikush ishte një maturante, e cila normalisht, duhej të ishte e ulur diku, në bangat e fundit të klasës, e të merrte në shënim leksionet e latinishtes. Romani u ribotua me po aq bujë dhe në Gjermani, Angli, Francë, e më

vonë u bë dhe film duke e dyfishuar dhe trefishuar skandalin letrar - të paktën këtë term përdori kritika letrare për romanin e Kardarelit, maturante italiane...

Të gjitha këto m'u kujtuan kur mora në dorë rastësisht romanin e maturantes shqiptare, Valbona Koçiu, me titulin invers "Pa mbiemër". Them invers, sepse kalku i zakonshëm do të ishte "Pa emër". Është një roman që të befason për shkeljen e guximshme të rregullave romanarke, për spontanitetin e ndjenjave, për brishtësinë, por edhe për mënyrën e të shkruarit. Një studjues i madh pat thënë se një 20 vjeçar që shkruan është thjeshtë një 20 vjeçar që shkruan; ndërsa një 40 vjeçar që shkruan është një romancier, një poet a një dramaturg. Më duket një pohim tepër cinik për ta besuar. Më tepër se kaq, pëlqej të them se një 20 vjeçar që shkruan është po ai që do të shkruajë dhe në moshën 80 vjeçare po që se do të jetojë aq gjatë. Dhe, duke u kthyer përsëri tek romani i Valbonës, do të doja që vemendja e kritikës, e ndalur përgjithësisht tek blloqet monumentale, të dinte të përkulej përpara shkrimtarëve të sotëm 18 apo 20 vjeçarë, për të pënë aty të deshifruar kodet e ardhshme të letërsisë shqipe.

RUDOLF MARKU

-Me shpejt, me shpejt!,...therriste nje person i gjate, trumadh, me fytyre te zakonshme, por pak te zymte. Veshtrimi i tij drejtohej here pas here mbi nje krevat te vogel, te rrethuar nga dhjetra aparatura te nderlikuara. Dhoma ishte madhe dhe kudo te binte ne sy nje bardhesi jo e zakonshme. Edhe veshtrimet e atyre njerezve te veshur me te bardha nuk ishin te zakonshme.

-Profesor, a ka shpetim?...pyeti nje i ri

-Te shpresojme ...tha profesori, qe uli koken akoma me shume dhe duart e tij nisen te leviznin me shpejtesi.

-Veshtrimi i tij tani ishte drejtuar perfundimisht mbi nje njeri. Ishte nje femije i aksidentuar. Dukej ne gjendje mjaft te rende perderisa dhjetra veshtrime te shqetesuara i ishin kushtuar ati. Fytyra e tij Dukej e zverdhur dhe trupi i tij i palevizur ne meshiren e duarve te profesorit, ne meshiren e ndihmesve te tij. Kerkoja ta shikoja me afer ate skene. Edhe mua me kishin hypur ethet e operacionit. Lutesha me veten time dhe kerkoja qe ai femije te shpetonte.

-Drite!, drite! ,perqendrohuni ja ketu ne te djathte...therriste i shqetesuar profesori,

-Matni pulsin!.

Keto ishin fjalet qe dilnin here pas here nga goja e tij. Djerset i kullonin curk mbi fytyren e zymte. Sigurisht

te zymte, sepse nuk ishte shaka te kishe ne duar nje jete femije. Perkundrazi ishte nje gje e tmershme.

-Tak, tak, tak... rrihte mjaft ngadale zemra e atij femije. Ajo sikur qante. Duart e doktorit vazhdonin te punonin. Djerset vazhdonin te rridhnin curk. Kjo ishte me te vertete nje qetesi e llahtarshme.

Kete qetesi e prishi, Danieli nje doktor i ri te cilit shqetesimi i kishte ikur.

-Profesor, shpetoi per bese shpetoi! Pulsiju rregullua!

Me ne fund pas afro 2 oresh veshtrimet e tyre u qetesuan. Nje gje me beri pershtypje, njekohesisht edhe me shqetesoi. Pse valle profesorin ky lajm nuk e gezoi. Ai vazhdonte te punonte.

-Penjte!, shpejt!, edhe nje cike mbaruam, Kaloi afro edhe nje ore. Me se fundi femija shpetoi. Profesori fshiu djerset dhe vazhdoi:

-Ky ishte nje rast teper i vecante. Ka pasur sigurisht organizem te forte. Tashti na takon tamam nje gote vere. He si thoni?

Ajo fytyre qe para nje ore ishte aq e zymte, tani kishte marre nje pamje gazmore.

-Ecni!... tha, dhe nderkohe i hodhi krahun nje kolegu te tij dhe te tere se bashku u nisen per te klubi me i afert. Kete gje e benin per te rimare pak vehten, pas asaj pune aq te tensionuar. Si thone shaka!... nga nje

bisturi varet jeta.

Klubi nuk ishte lart spitalit. Ata arriten shpejt. Pronari i klubit, posa i pa, i ftoi te uleshin ne nje nga vendet me te preferuara. Kjo gje nuk e cudit shume profesorin mbase ai e njihnte mire karakterin e zotit Mishel. Ai ishte nje burre topolak aq bullafiq sa qe cdo person apoklient i ri, qe vinte, hutohej. Vete Misheli krenohesh me shendetin e tij, si dicka e vecante, qe sigurisht asnjeri prej klienteve te tij se kishte. Ishte njeri babaxhan dhe gjithnje me buzen ne gaz. Me te mund te beje cdo shaka dhe s'ta merrte aspak per keq. Nje dite Xhini e kishte pyetur me shaka:

-Zoti nderuar Mishel, si beni per te lidhur kepucet me gjithete ate shendet?

Ai i ishte pergjigjur: -Si lidh fare!

Ngakjo pergjigje Xhini kishte mbetur goje hapur nga habija.

Nuk e priste nje pergjigje te tille nga Misheli. Zoti Mishel ishte rreth te 40-tave, moshatar me profesorin. Te dy ishin shoke jete madje dhe te nje shkolle. Ky ishte shkaku, qe profesori me koleget e tij pati miresine t'i ulte ne nje nga vendet e rezervuara.

-Urdheroni veren!...foli nje kamarier plot miresjellje. Aroma e saj nxiste flegrate hundes. Profesori kete gje e shpjegonte shkencerisht. Pikerisht per kete gje

shoket e kishin quajtur "Idhulli i diturise", nofke e merituar vetem nga ky shpjegim lidhur me veren. Kesaj radhe ata nuk nisen te bisedonin, si zakonisht, per ndodhite e cdo dite. Vemendja e tyre ishte perqendruar tek femija qe shpetoi. Ishin te gezuar, por edhe te shqetesuar se cdo te behej me kete femije. I pari e mori fjalen profesori:

-Degjoni djema, problemi eshte se deri tani atij nuk i ka ardhur asnje i aferm per ta shikuar. Se dyti ai ka marre nje goditje mjaft te rende pas koke dhe kjo gje ka rrezik. I shpetuam jeten ti shpetojme edhe trurin. Pastaj te shohim ne i gjejme prinderit e tij.

-Si ka mundesi, qe ju profesor se keni marre vesh?... tha Danieli

-Cfare te merrja vesh?

-Sipas jush shenja te tilla goditjesh si ato te femijes nga se mund te shkaktohen?

-Nga ekzaminimi qe beme rezulton, se te tilla mund te merren vetem ne aksidentet me makina, vetem nga goditjet e fuqishme.

-Ketu ndalu!... e nderpreu Rozi, sepse ne kembe kishte edhe shenja djegjesh,

-Hm. peshperiti si me mos perfillje Danieli dhe vazhdoi: -Ate e solli nje nga personat e policise dhe me sqaroi qe e kishin gjetur prane kufirit, te perplasur. Makina ishte gati te merrte flake. Te vetmin person, qe

arritem te shpetojme ishte femija, pastaj makina mori menjehere flake. Shoku im qe e kishte shpetuar tha se ne makine ishin nje burre dhe nje grua dhe shoferi, vec

~~djali~~
-I shkreti djale!. Duhet te kene qene prinderit e tij .tha Xhini

-Pse s' thoni njeqind per qind ata ishin prinderit e tij. Si do t' ia bejme tani?

Te tere rane ne mendime. Misheli here pas here i shikonte dhe cuditej se si kaq papritur , te tere u bene serioze si me magji. E keqja ishte se Misheli u besonte magjive.

-C' ndodhte nderkohe ne spital?.

Profesori ishte larguar me koleget e tij, por megjithate infermieret leviznin te shqetesuara. Ishin afro pese ne dhomen ku qendronte femija. Ne syte e tyre kishte gezim te madh por njekohesisht edhe kujdesje. Femija rrinte ne shtrat i palevizur. Narkoza nuk i kishte dale, djali ende nuk po zgjohej. Kjo gje e rriste shqetesimin e infermiereve dhe kryesisht te asaj, qe rrinte prane kokes se krevatit, duke pritur me durim. Ishte nje vajze e re , e gjate ,elegante, me floke te verdhe edhe me sy te kalter.

Ishte e heshtur dhe njekohesisht e duruar, rrinte e

palevizur sikur donte ta bashkeshoqeronte ate femije te qete, qe ende nuk po permendej. Dy persona, te dy te palevizur: njeri ne prag te jetes se re dhe tjetra ne lulen e jetes. Here pas here syte e saj te kalter dic kerkonin te zbulonin ne ate mister gjumesor. Dukej sikur infermierja ishte vene te ruante kete djale, thua valle se do ta grabisnin.

Qetesi. Vetem peshperimat e lehta te infermiereve degjoheshin. Vetem kaq.

Papritur trupi i saj levizi, syte e infermieres shkelqyen dhe ajo u ngrit duke thene:

-U permend!

Qetesia u prish.

Infermieret u grumbulluan rreth krevatit ndoshta per te vertetuar fjalet e shoqes se tyre. Nje gezim u perhap tek te tere.

-I shkreti, djale!, me ne fund!.. tha nje meso grua me dhembshurine e njenene, dhe u drejtua per te lajmeruar profesorin ne telefon.

Po te hidhje syte tek fytyrat e Danielit, Rozit, Xhinitaq me teper te profesorit, cdo kush do te vinte re se ato ishin te zymta, ndoshta nga perqendrimi i madh. Te tera veshtrimet e tyre te drejtuar mbi tavoline, e cila gati nuk po thyhej nga pesha e tyre.

Kishin afro 10 minuta qe rrinin, si te paralizuar. Kjo gje kishte terhequr edhe vemendjen e klienteve te tjere. Misheli bullafiq, rrinte i ngrire me syte sa nje filxhan, te drejtuar nga profesori. Nje djalosh i ri i quajtur Francesko ia dha nje fishkellime aq te fuqishme sa te tere u hodhen perpjete, sikur t'i kishte shpuar nje gjilpere. Misheli shume kurioz u afrua dhe tha:

-E pro... pro... profesor c' kemi?

Aq shume ishte turbulluar i shkreti Mishel sa iu muar goja, dhe vazhdoi:

-Si ju duk vera?

Profesori ia ktheu qete qete se fatkeqesisht ende nuk e kishte provuar. Po ate cast e mori goten, piu ngadale nje gllenjke dhe ngriti koken duke thene:

-Mjaft e mire!

Kur klientet ia lavderonin veren zotit Mishel, ai gezohet pa mase, dhe behej shend e vere. Por kesaj radhe ai buzeqeshi me zor. Sigurisht, ai nuk e kishte hallin aty. Kurioziteti i tepert e mundonte. Nuk mund te thoje kursesi se zoti Mishel ishte budalla. Vetem se pyeste shume.

-Profesor perse pak me pare po mendoheshit aq shume? Per syte ballit qe na hutuat me ate seriozitet qe morret..

-Probleme pune, Mishel... -Ne s'gaboj nuk me kane degjuar veshet ndonje here, qe ne nje klub argetimi t'i

kushtohet kaq vemendje problemeve te punes?...foli me nje ton pyetes duke zgurdulluar syte nga habija akoma me shume. E duke vazhduar teper i qete tha:

-Ju befte mire!

Pastaj u kthye perseri ne banak per te vashduar punen e tij. Mbas kesaj bisede u gjallerua perseri ne klub. Por profesori e shihete pamundur qe te shkeputej nga ajo bisede, te cilen e lane pergjysem, pikerisht ne momentin kulminant. E keqja ishte se kishin ngelur ne vend.

-Si dot'ia bejme profesor tani?. Asnjeri prej nesh nuk ka ndonje propozim...foli i pari Danieli.

-Edhe une s'kam ndonje mendim. Me vjen cudi edhe me vehten time, se si ka mundesi qe te humbas tere kete kohe dhe si shperblim nje hic.

-Profesor a nuk e leme te pyesim djalin kur te sherohet nese ka te aferm?. Kjo mendoj une do te ishte zgjidhja me e mire..., tha Xhini.

Nje ze u degjua. Ishte zeri i kamarierit.

-Profesor, ju kerkojne urgjent ne telefon.

-Nga moren?...pyeti profesori, i paduruar.

-Nga spitali.

Profesori u ngrit menjehere duke u drejtuar nga telefoni. Dic duhet te kishte ndodhur. Per mire a per keq kete ai nuk e dinte. E ngriti aq shpejt telefonin sa qe u godit ne koke. Por kjo nuk kishte ndonje rendesi.

Mjaft qe ankthi ti ikte shpejt -Alo!..Po,poju degjoj shume mire...u permend ?..Po vij menjehere!..Faleminderit.

Gjer ne ate moment ai nuk e kishte ndjere dhimbjen qe i shkaktoi ai i mallkuar telefon. Me doren ne vendin e goditjes ai u drejtua me te shpejte nga shoket, qe po e prisnin.Professori zakonisht u shmangej gjithnje bresherive te pyetjeve, por kesaj radhe nuk iu shmang dot.

Professori mblodhi veten dhe tha:

-Shpejt ne spital!, femija u permend!

Te tere u ngriten e u drejtuan per nga spitali.

Arriten aty rreth ores 10 dhe u drejtuan me shpejtesi per nga shkaillet. Koha s'priste.Professori duhej te ishte atje, ne ato caste, por ato te mallkuara shkalle sa shume po e vononin, sepse ashensori kish pesuar nje difekt. Vrap e vrap me ne fund arriten.Fytyrat e shtremberuara nga lodhja moren pamje serioze. Kokat e tyre te ulura aq shume sikur donin te puthnin kraharorin, u drejtuan kur arriten para krevatit te femijes.

-Largohuni te tere!..urdheroi profesori, duke marre fryme thelle veshtrori me kujdesje djaloshin.

-Me ne fund!...peshperiti ai.

-Duart e juaja, profesor, bejne gjithnje mrekullira. tha nje nga infermieret e gezuara.

Profesori buzeqeshi.

Sa here qe buzeqeshite, fytyra e tij merrte nje pamje te vecante nga dy gropezat qe i krijoheshin mes faqeve. Nga casti ne cast mund te prisje prej tij cdo gje. Mund te ishte i zymte dhe papritur fytyra e tij te kthehej ne nje fytyre te qeshur. Mund te ndodhte edhe e kunderta. Kete gje e dinin mjaft mire koleget e tij madje edhe e argumentonin.

-He djalosh!?, e sheh c' thone koleget e mi, qe une bej cudira. Jo, jo ne asnje menyre se pranoj komplimentin. Merreni mbrapsh!..tha profesori si me tallje. Dhe si per te sqaruar ktheu koken nga djali: -Bukurosh i vogel, ishte organizmi yt, qe beri kete mrekulli.

Femija ishte permendur. Tani, shihje ngjyren esyve te tij. Ishin te zinj. Fytyra e tij ish e vogel, dhe ende nuk e kishte marrë ngjuren e kuqerremte. Syte e tij gjysem te hapur shetisnin si me ndrojtje ne ate mozaik veshtrimesh te panjohura. Here here perseri femija humbiste ne vetevehte. Mbyllte syte e zinj duke shtrenguar nofullat. Kishte teper dhimbje.

-Ju thashe te tereve te largoheni!..foli prape profesori, dhe nisi te pergatiste qetesuesin. Mbasi u krye kjo pune, te tere u larguan dhe ne dhome mbeti vetem infermierja me djalin, qe kishte rene ne gjumin

e c' lodhjes. Vajza infermiere e mbuloi. Me ne fund edhe ajo u largua per ta lene te qete. Ne dhomen e erret mbeti vetem djali.

E nesermja erdhi si cdo dite tjeter. Qielli tek tuk ishte renduar se tepermi nga rete e zeza. Ishalla nuk bie shi mendova ato momente, sepse ai me dhuronte vetem trishtim.

Profesori po ngjiste shkallet duke mermeritur neper dhembe:

"Me duket se jeta do me shkoje vetem duke ngjitur keto dreq shkalle". Fliste dhe nxitonte. Xhini e degjoi dhe duke qeshur iu drejtua.:

-Inderuari kolet sot qenke ngritur ne qejf perderisa po kendon. Profesori i vrenjtur iu hakerrua:

-Nuk e sheh qe sot nuk jam ne humor te mire?, ti ke nge per shaka. S'kam fjetur tere naten.

Por Xhini vazhdoi:

-A mos vuani nga pagjumesia?

Profesori me te vertete ato momente nuk mbante me shaka. Fytyra iu vrenjt.

-Te thashenje here, me lere rehat dreqite marre!. S'pret puna. Te shkojme te shohim djalin ne spital.

Spitali kishte marre perseri gjalleri. Infermieret leviznin me shpejtesi. dhe here pas here ngrinin koken te

shikonin qiellin ende te vrenjtur.

-Si eshte gjendja e femijes?...pyeti sapo hyri profesori

-Pa te shohim pak..

Ai u drejtua nga djali qe ishte i zgjuar.

-Si e keni emrin?

Djali e veshtroui me cudi gojen e profesorit qe levizi. Asnje pergjigje.

-He djaloshi emrin si e keni? S'ka lezet te te therrasim vetem djalosh.

Perseri asnje pergjigje. Profesori i merzitur po e veshtronte me kujdes.

-Profesor akoma i merzitur me mua jeni? ..e nderpreu Xhini

Por profesori s'ja kishte shakave pa kripte te Xhinit. Iu afrua qete qete dhe i tha

-Xhin, shko pyete femijen si e ka emrin!. Mbase te pergjigjet.

-Mire...iu pergjigj Xhini

Ngriti koken, i shkeli syrin femijes duke i thene:

-E king, si e ke emrin?

Asnje fjale, vetem nje buzeqeshje si pergjigje pamjes qe mori Xhini ato momente. Mendoi se djali po tallej me te. Kete ai s'e duronte. Edhe profesori po qeshte. Por nuk zgjati shume. Perseri profesori mori pamje serioze. Dicka duhej te kishte ndodhur.

-Daniell!, Xhin!, ejani ketu.

-Cka ndodhur?..pyeti Danieli duke i shikuar fytyrat e te dy kolegeve te tij serioze.

-Degjoni ketu, kam frike se mos ka pesuar gje truri, vazhdoi profesori.

-Perderisa ai s'flet, kjo duhet te jete...mendoj Xhini.

-E pamundur. T'i bejmenje here ekzaminimin. S'kemi si flasim pa baze.

-Ashtu eshte por ja kam friken.Gjithe ajo goditje shemB nje peme e jo me nje tru femije Por ta provojme. Teshpresojme....tha profesori.

-Ecnj atehere. Flora, beje gati femijen per ne salln 31!..iu drejtua Danieli i gatshem per te bere cdo gje per ate femije.Dukej qe i kishte hyre ne zemer.

Salla ishte bere gati. Infermieret e kishin kryer punen me se miri.Ne ekranin e kompjuterit shfaqej truri i femijes ne pozicione te ndryshme. Te tere veshtronin me vemendje.

-Nuk po shoH ndonje difekt ne vatren e te folurit...tha disi i gezuar profesori.

Djalin e cuan perseri ne vendin e tij. Tashti ne salln 31 kishin mbetur tere mjeket. Pasi profesori iu kishte argumentuar shkakun e dyshimit te tij, :te tere u perqendruan mbi te dhenat e aparatures. Asgje. Asnje demtim ne ate zone.Papritur njeri nga koleget iu afrua

profesorit.

-Mos eshte shurdh?. Ky mendoj do te jete shkaku.

-Jo, jo ..tha Xhini...veshtroni vatren e degjimit. Ne s'gaboju ne nuk shoh ndonje demtim.

Te tere hodhen syte dhe e kuptuan qe Xhini kishte te drejte. Rane ne mendime.

- Keshtu nuk kemi per te nxjerre asgje...tha profesori. Daniell!, Xhin!, shkoni tek femija. Pyeteni prap. Zbuloni dicka. Une po rri ende ketu. S'do vonohem as gjysem ore. Ikni tani.

Te dy u larguan me te shpejte duke nxituar neper korridor. Hapat e tyre kercisnin mbi dyshemene e bardhe. Kjo terhoqi vemendjen e Rozit.

-Mos po beni gje gare?. Apo nuk eshte piste e mire ky korridor. Kujdes te pakten se mos thyeni koken...foli tere qesendi Rozi, duke u larguar.

Po ate cast Xhini pesoi nje shkarje, por e mbajti Danieli. Te dy po vrisnin mendjen se si kishte mundesi, qe cdo gje qe thoshte Rozi te dilte. Dhe pa nje pa dy ia plasen te qeshurit.

-C'behet ketu? ..nderhyri profesori.

Te dy u ngriten dhe u drejtuan bashke me profesorin per nga salla ku rrinte tani femija.

Nga qielli i vrenjtur kishte filluar te binte nje shi i furishem, qe perplasej ne dritare, duke krijuar nje

zhurme te bezdisshme Djali here pas here veshtronte nga dritarja shiun e zhurmshem. Syte etij te zinj ishin te friksuar. Per nje moment ai ktheu koken ,sepse ndjeu nje zhurme. Kishin ardhur ata te tre: Danieli, profesori dhe Xhini. Ata filluan me durim ta pyesnin per shume e shume gjera. Por ai vetem buzeqeshte. Asnje pergjigje.

-Si e ke emrin?.. iu kercenua Xhini, i cili e kishte humbur durimin. Femija e pa me cudi por edhe me frike ate fytyre teper kercenuese.

-"C'kane keta me mua keshtu?. Perderisa nuk i marr vesh nuk kam se si te flas. Kjo eshte e natyrshme. Nuk di se si te veproje" ..po mendonte ato momente femija.

-Mjafi me! Jo keshtu del.. e qortoi Xhinin profesori, e duke treguar me gisht femijen vazhdoi: -S' e sheh qe eshte femije e mbi te gjitha ende i pa sheruar.

Xhini me fytyren e kuqe flake u largua. Ngeli vetem profesori me Danielin. Profesori iu drejtua prape femijes dhe si me lutje i tha:

-He pra na thuaj nje fjale!. Thuaj : A.. A.. A..!

Femija dicka kuptoi:

-"Kerkon qe te them A.. A, e pse pikerisht do kete?. A mos valle me pandehin memec?. Kjo do te ishte dicka e tmerrshme per mua.

C' duhet te beje.?", dhe duke ngritur koken belbezoi:

-A..A..A

Profesorit i lindi nje shprese dhe vazhdoi.

-Thuaj; B..B..B.!,

Djaloshi ate cast u cudit akoma me shume duke shikuar ate fytyre te paduruar.

“C’duan keta ende me mua?...mendoj ai prape...Mos duhet te them tere shkronjat e alfabetit.Kjo per mua do te ishte nje torture e vertete. Asnjehere nuk me ka pelqyer te them alfabetin.”

Profesori priste por asgje.Atehere ai vendosi te largohej.Mbase dita tjeter do te sillte ndonje gje te re. Sot kishin bere shume pune. U kthye nga dera per t’u larguar duke thene:

-Ti teper i vecante. Ec ikim, Daniel!

Ai s’kish bere as dy hapa kur per nje moment shtangu.Dikush po e perqeshte. .

-Ti..tip te..per i ve..cante. Shume, i turbulluar profesori ktheu koken nga Danieli, dhe pa qe Danielit fytyra i kishte marre nje pamje tjeter. Ai po buzeqeshte duke shikuar here pas here femijen.Edhe femija po qeshte. Sigurisht pa ze.

-C’po ndodh keshtu?.

Profesori nuk priti shume. Pergjigjen ia dhane fjalet: “Ti.ti te..per i ve..cante”, te cilat u thane nga femija. Pamja e tij e zymte tani u ndricua nga lumturia.

-Bravo!, bravo!, te lumte!.

-Bra..vo!, bra..vo!, telu..me..te!,...perseriti femija.
Tashti profesor ishte edhe i cuditur. Pse valle ai perseriste fjalet e tij sikur te ishte papagall. E rendesishme ishte qe femija nuk ishte memec. Per te tjerat koha priste. Ishte erresuar. Te dy u larguan duke u pershendetur me djalin.

-Naten e mire!,

Dhe femija i sjellshem po ate pergjigje u ktheu.

-Na..ten e mi..mi..re!.

“Sa mot i keq.”, po mendonte ato momente profesori, qe sapo ishte zgjuar. Me se fundi kishte bere gjume pothuajse te qete. Por ende ish i shqetesuar per femijen. C'fare eshtynte qe te perseriste fjalet e tij. Te tera keto mendime e shqetesonin pak si teper duke i ardhur rrotull si vorbull.

-C'ke burre?...e pyeti gruaja, qe sapo ishte zgjuar...Me dukesh pak si pa qejf. Dhe duke vendosur duart tek balli i tij vazhdoi:-Mos ke gje temperature?

-Jo, jo s'kam gje, do nisem per ne spital. Kam ca pune...tha ate moment duke u ngritur me te shpejte.

-Mes ketij shiu. Madje as ora per te vajtur ne pune nuk ka ardhur. Eshte ende heret.

-Ika e dashur. Kur te vij do te sqaroje...tha, duke

ularguar profesori.

Bubullimat oshetinin. Toka dridhej nga zhurma e tyre. Ne spital arriti shpejt me nje fryme. Nuk priti por u fut ne laboratorin e tij. **Desh te shikonte me mire te dhenat e femijes.** Cuditerisht profesorin dic e shtynte nga thellesia e shpirtit se femija do sherohej plotesisht. Por nga ana tjeter ish paksa i paqarte, se c' mund te kishte pesuar truri i atij femije. Bubullimat vashdonin fuqishem. Profesori ishte ende ne laborator i zhytur midis dokumentave te djalosht. Enigma here zgjidhej here komplikohet. Dukej sikur asnjehere nuk do te kishte fund.

-Paskeni ardhur heret, profesor...tha Xhini qe sapo kishte hyre.

-Mbase po edhe mundet...iu pergjigj ai ,dhe duke ngritur koken nga dokumentat iu drejtua Xhinit:

-Ende fle femija?

-Po, Xhini hiqej si ti mos perfilles por ne te vertete nuk ishte i tille. Ishte njeri zemerbardhe. Edhe ai kishte ardhur heret. Kjo Dukej nga floket qe i ishin bere si iriq nga shiu, ndonese Xhini ishte munduar t'i rregullonte, por pa ja dal. Edhe ai si profesori ish i shqetesuar.

-A foli femija?...pyeti ate moment Xhini.

-Po...iu pergjigj profesori...Po ty kush t'a tha?

-Me mori dje Danieli ne telefon dhe me lajmeroi. Sec

kishte ne te foluren e tij. Kjo me cuditi.

-Eh na ka dale nje problem tjetër. Ai vetem perserit duke belbezuar fjalet tona.

-Si?, profesor... zgurdulloi syte Xhini.

-Po, po, Xhin!, menjehere sa ike ti.

Te dy rane ne mendime. Pastaj u drejtuan nga zyrat e punes. Prisni te zgjohej femija. Zyrat e punes te profesorit

dhe te Xhinit ishin krah njera tjetres. Te dyja teper te ngjashme. Dy zyra te njejta per dy persona komplet te kundert. Ato caste profesori ishte ulur dhe ne heshtje shikonte lindjen e diellit. Stuhia kishte pushuar me kohe. Koha po ikte me te shpejte. Ishte ora e fillimit te punes. Shumica prej tyre sapo erdhen, kurse te tjeret si profesori dolen nga zyrat e tyre. Vetem njeri ato momente e kishte prishur kete rregull. Ai ishte Xhini, i cili nuk po dilte nga zyra e tij. Profesori doli ball per balle me Rozin. Sa e pa ajo nisi te qeshte.

-Cili eshte shkaku i ketij humori te tepert?... pyeti qetesisht profesori.

-Xhini, zoti profesor.

-Vetem ai?

-Po, natyrisht.

-Mire atehere shko tek Xhini e thuaj te dali prej strofkulles se tij. Ndoshta e ka zene gjumi. Mbase enderron... vashdoi duke u larguar ai dhe njekohesisht

duke e pare me bisht te syrit.

Xhini prej kohesh e simpatizonte shume Rozin. Kete gje profesori e dinte. Madje thoshte se nje nga shkaqet e hutimit te tij ish Rozi. Rozi ishte nje grua e padjallezuar. Pamja e saj teper e bute. Ishte e cilter, dhe gjithnje me buzen ne gaz. Syte i shkelqenin forte. Ishte teper e bukur. Xhini sa here qe ndodhej balle saj, nuk mund te rezistonte. Ulte koken dhe largohej me shpejtesi. Ai e kishte pohuar edhe vete se veshtrimi i saj ishte si shigjete. E kjo shigjete gjithnje e plagoste te shkretin Xhin.

Pas pak Rozi arriti tek zyra e Xhinit ashtu sic e kishte porositur profesori. Hapi deren duke bese nje cike zhurme ne menyre qe kolegut te saj te mos i vinte e papritur. Por ate moment ne vend qe te shtangej Xhini, ushtang Rozi kur vuri re se dic po levizte nen tavoline. Ajo menjanoi paksa koken dhe me ze te ulet pyeti: -Xhin...Xhin, ti je aty?

Xhini nen tavoline menjehere e njohu zerin e per t'u siguruar akoma me mire zgjati koken nga nen tavolina. Fatkeqesisht pra Xhini u hutua. U ngrit me te shpejte, pa u menduar se siper kokes se tij ishte tavolina. Duke shtrenguar dhembet ai u ngrit. Rozi po e shihte me keqardhje, kurse Xhinit i dukej sikur ajo tallej me te. C'te bente ai kur te keqijat vinin vete. Me ne fund e mblodhi veten dhe pyeti.:

-Perse me therrite?. Mos ka ndodhur ndonje gje me djalin?

-Jo ,jo asgje vetem se profesori me dergoi te te kerkoj. Te tere kane ardhur.

-Kaq shpejt?,

-Aspak, ora eshte afro 8 e mengjesit!.. tha Xhini Tashti ai kishte marre pamje serioze. Mbase ky kuriozitet dot 'i sillte mbaresi. Ato momente Rozi po mendonte se c' deshte valle Xhini poshte tavolines. Ky kuriozitet po e mundonte se te permi por asaj i vinte zor ta pyeste. Nderkohe edhe Xhini po mendohej. Ish hera e pare qe ai mendonte aq seriozisht.

Me ne fund arriten tek dhoma e djalit. Aty ishte profesori me nje infermiere. Xhini sa hyri vuri re se djali qe zgjuar. Iu afrua dhe po e veshtronte me kujdes, a thua se po filozofonte.

-Cfare ke Xhin?.. e pyeti profesori

-Asgje profesor!...tha, dhe uli koken per nga djali. Vuri doren mbi ballin e femijes. Temperatura i kishte rene. Xhini tentoi ta pyeste perseri:

-Si e ke emrin?

Femija buzeqeshte. Ai e njohu njeriun qe e kishte pare para ca oresh. Femija rrudhi vetullat, perdodhi buzet sikur desh te imitonte pamjen e ketij doktori dhe nisi te qeshte me ze, duke thene ca rrokje pa kuptim. Xhini pyeti seriozisht:

-Si e ke emrin?, Si?

-Si...e...ke...emr...rin

Xhini u bind se femija donte te fliste dhe perseriste fjalet e tij. Kete gje Xhini nuk e shpjegonte dot.

-Boll, Xhin! Se sheh qe femija ende nuk eshte fare mire?... foli Rozi

-Jo ai nuk ka fare temperature... ia ktheu teper i sigurte ai.

-Kjo s' do te thote qe ai eshte bere mire.

Me se fundi Xhini u largua tek pacientet e tjere. Per ate femije ishte ngarkuar te kujdesej profesori me Rozin.. Kaluan disa dite. Perseri i njejti intinerar: spital, shtepi, spital. Ndonjehere pas pune shkonin edhe ne klub per te biseduar me pronarin e tij , zotin Mishel Harrova t'ju them se zoti Mishel mbiemrin e kishte Fleiger. Mishel Fleiger ishte xhaxhai i Rozi Fleiger. Ky ishte shkak qe gjithnje Misheli bisedonte me profesorin dhe me koleget e tij. Biles edhe per ceshtje pune. Gjithnje profesori i drejtohej atij:

-Djalli vete je!. Edhe punet tona i merr vesh.

-C' ti besh profesor ...ia kthente ai si me mburrje...e kam pasion degen tuaj.

-Atehere pse nuk u bere mjek?. Do te te kisha koleg.

-Ju ne pergjithesi jeni te dobet. Shendetin tuaj ua falni pacienteve. Kurse une kete gje se kam deshiruar ndonje here...ia ktheu me seriozitet Misheli si gjithnje.

Tetera ai i merrte vesh nga Rozi Fleiger. Mbase edhe per ate femije , qe u aksidentua ai e kishte marre vesh, perderisa edhe ato dite ai bisedonte vazhdimisht me profesorin ,Xhinin, Rozin dhe Danielin. Aq shpesh vinin ata ne klub sa edhe Misheli i kishte cilesuar "miqte e mi te perditshem". Persa i perket Xhinit ai nuk mungonte kurre ne klub. Ishte me korrekti. Nje dite Misheli e kishte pyetur:

-Zoti Xhin, a mos valle e konsideroni klubin tim si variete?

Xhini qe se kishte kuptuar se ku donte te dilte Misheli me keto fjale , kishte thene:

-S'po te kuptoj!

-Mos e shfrytezo klubin si variete, per shakate e tua. Ke per t'u konsumuar fare. Vjen ketu serioz e na del duke u gajasur. He , a kuptove? -Po por c'ti besh Mishel kur te vjen te qeshesh?

Keshtu me shaka ne klub e me seriozitet ne pune kalonin ditet. Cdo dite qe kalonte sillte nje permiresim te ndjeshem te femijes se aksidentuar dhe shenje padurimi tek doktoret e mbi te gjitha tek profesori. Ata mezi prisnin te merrnin vesh per familjen e tij e cila tashme ishte kthyer ne nje enigme.

Ishte pranvera e vitit 1986, kur femija ishte sjelle i

aksidentuar. Nuk kishin kaluar as dy jave dhe asgje ne drite.

Nje pacient i vecante, qe po i lodhte se tepermi doktoret. Gjendja e tij ishte permiresuar mjaft, aq sa ai mund te ngrihej ne kembe. Por nje gje nuk kuptonin:

-Perse ai nuk fliste?

Para disa ditesh Rozi kishte vene re se femija fliste here pas here naten. Profesorit e Xhinit i bente pershtypje se pse Rozi kerkonte me ngulm qe prane femijes, naten te rrinte vetem ajo.

Ishte fundi i javes se dyte, qe Rozi qendronte prane femijes. Dukej se femija u kishte hyre ne zemer. Dic duhet te kishte ndodhur. E mire a e keqe kete nuk e merrnin vesh. Por nuk vonoi shume, kur ate dite, 2 prill 1986, Rozierdhi me vrap telajmeronte profesorin.

Ishte turni i nates. E shqetesuar por edhe nje cike e gezuar ajo e kerkoi ne cdo ce te spitalit. Profesori ishte larguar. Duke marre fryme thelle ajo u ul prane femijes sikur kerkonte te vertetonte dicka. Pastaj u ngrit pra dhe me ne fund dicka shkelqeu ne syte e saj. Pa dhe njehere femijen, qe po flinte dhe vrapoi tek telefoni i spitalit.

-Alo, alo! Ju lutem urgjent zonjen Meri Gleizin.

-Me vjen keq po nuk ndodhet ne shtepi, u pergjigjen ne anen tjeter te fillit.

-Kur mund te vije?

-S'edi . Mirupafshim e pershendeti nje ze i panjohur per te.

Teper e merzitur, Rozi mbylli telefonin dhe u drejtua nga femija qe po flinte ende. Rrinte e heshtur dhe priste. Ndoshta priste qe mengjesi te vinte sa me shpejt. Tek tuk ajo shihte edhe infermiere te tjera qe leviznin ne korridor. Por me ato ishte e pamundur te bisedoje. Spitali ishte teper i madh . Asnjera prej tyre nuk mund te dinte gje per femijen, ashtu sic nuk dinte ajo per pacientet e kateve me siper. Kjo ishte dicka e natyrshme. Qetesia qe kishte pushtuar dhomen e femijes e shqetesonte se tepermi Rozin. Ajo sikur e mbyste. Kjo gje me perparas i kishte bere pershtypje. Veshtrroi nga dritarja. Nje nate pis. Ne qiell dukeshin tek tuk yje te rralle. Natyra e gershetuar me heshtje e tmerrshme bente qe koha te Dukejshkej. Rozi rrinte ne pritje me syte gjithnje nga femija. Por mengjesi ende nuk po vinte.

Nderkohe Xhini ndodhej ne shtepi. Ne koke kishte lidhur nje peshqir te lagur. Koka i dhimbte aq shume sa mezi flinte. Ne dore mbante nje bllok te kuq , qe para ca kohesh Rozi ia kishte kerkuar dhe qe ai mezi e kishte gjetur. E kishte pare bllokun nje dite ne zyren e saj. Ne te kishte vetem disa fjale te pakuptueshme, te cilat ai po i veshtronte me vemendje, duke pyetur se perse valle i duheshin ato asaj. Ne cast mendoj te

marre ne telefon Rozin, nderkohe qe Rozi ne spital po mendonte te merrte ne telefon Xhinin. Por asnjeri as tjeri nuk e ngriten telefonin. Te dy priten mengjesin. Edhe nata ka nje fund, sic ka edhe dita. Me ne fund erdhi mengjesi me bukurite e tij por edhe me enigmat e dites se re. Ishte mengjesi qe e prisnin Rozi dhe Xhini. Po tani qe erdhi cdo te ndodhte?

Zilja e ores ate mengjes nuk e besdisi aspak, sepse ishte zgjuar, rrinte me duart mbi balle dhe syte i kishte te buhavitur. Shikimi i tij ato momente ishte pa jete. Por tani, qe zilja kishte rene ai kishte te drejte te drejtohej per nga spitali. Arriti atje me nje fryme. U ndal. Desheronte te futej por kishte ndrojtje. Mori kurajo dhe se fundi u gjend perpara Rozit.

- Miremengjes, Rozi!,

- Oh! Xhin sa mire qe erdhe!,

Ato momente Xhini zgurdulloi syte, u gellitit duke menduar se ajo mezi e priste. Rozi pasi e pa qe Xhini s'kish ndermend te fliste e mori fjalen:

- C'te shtyu qe erdhe kaq heret Xhin?. Ti zakonisht s'e ke zakon?

“Sa inat!. Cdo fjale qe thoshte Rozi e trondiste”.

- Rozi!, para disa ditesh padashje te kam marre nje bllok te kuq. Ne te kam prishur pune, te me falesh. Por

s'besoj perderisa atje kishte vetem ca fjale pa kuptim. Ne fakt per kete erdha. Te them te drejten s'e marr vesh ku i gjete tere ato fjale?

Rozi ia plasi te qeshurit. Xhini e shikonte i habitur, dukemenduar erimenduar fjalet qe tha. Pos'e kuptonte se c'gje qesharake kishte ne ato qe tha.

-Ne fakt, Xhin ato fjale me duheshin me shume nga c'mendon ti.

-Te kam prishur pune?... ia ktheu teper i shqetesuar ai.

-Paksa, por tani as qe e kam problem. Ia arrita qellimit. Sa mire qe erdhe Xhin. Mezi prisja, prisja te vinte ndonje e t'ia thoja ate qe kam vene re. Me ne fund!

Xhini s'po e merrte vesh ku donte te dilte ajo me ato fjale.

-Xhin, afrou ketu, afer femijes, vazhdoi ajo... afrou se do te te them dicka teper te rendesishme.

Xhini beri dy tri hapa dhe u afrua i kenaqur prane Rozit.

-Xhin kemi gjithë keto kohe qe femijen e degjojme te perserise fjalet tona. Ti e di qe tere keto dite kam ndenjor une prane femijes.

-Po. Madje e ke kerkuar vete kete gje.

-Po sigurisht. Por jo pa qellim. Degjo mire. Cdo nate femija flet ne gjume.

-Ketu nuk ka ndonje gje te vecante per t'u habitur... ia

ktheu Xhini teper i sigurt.

-Jo perkundrazi. Ne gjume femija fliste ca fjale pa kuptim. Sigurisht as une nuk i merrja vesh. Por tani ndryshon puna ... ia ktheu si me mburrje ajo.

Xhini biseda po i dukej akoma me interesante, prandaj i kishte hapur veshet mire; goja i rrinte paksa e hapur. Rozi e vuri re qe Xhinit po i interesonte dhe vazhdoi:

-Ne ate bllokun e kuq kisha shenuar fjalet qe thoshte ne gjume. Papritur nje dite duke ndejtur prane femijes degjova nje fjale te njohur.

-Domethene se ai di te flas. tha i kenaqur Xhini.

-Ketu eshte problemi..... por jo ne gjuhen tone.

-Si pra na qenka i huaj?

-Po natyrisht. pasi mora vesh kete fjale shkova ne zyren time per te marre bllokun. Por nuk e gjeta. E kisha marreti; Xhin.

Xhini uli koken. Ajo vazhdoi:

-Keshtu qe duhet terrija edhe disa nete prane femijes per te degjuar fjale te tjera. Me se fundi vendosa te bisedoje me nje shoqen time psikoanaliste. Quhet Meri Gleizi.

Ate moment Xhini rrudhi vetullat. Njehere ishte zene me te.

-Ah!, e njoh.

-Ajo me ndihmoi shume. Edhe ajo pohoi se femija

dinte gjuhe tjeter, prandaj kur e pyesnim si e kishte emrin , ai nuk pergjigjej. Por me tha dicka qe me merziti.

-Cfare?...nderhyri Xhini.

-Ajo tha se femija mund te kete humbur kujtesen. - Megjithemend?...tha si me tallje Xhini duke u munduar ku e ku te kapte ndonje gabim tek Meri.

-A eshte i huaj?. C'te keqe ka ketu te flasi ne ate gjuhe. Sipas asaj filozofise sate cdo i huaj do te cilesohet me humbje kujtese!

-Jo, Xhin!. S'me kuptove. Femija s'ka asnje te keqe te flasi ne ate gjuhe. Por problemi qendron tek fjalet qe thote. Ne radhe te pare i thote me veshtiresi dhe teper gjysmake. Veshstro! Ate cast ajo zgjati doren. Xhini u frikesua. C'deshte ajo nga ai?

-Xhin me jep nje moment bllokun!.

Xhini ja zgjati .

-Degjo ketu!. Do mundohem pak te te perkthej, sepse keto kohe e kam studiuar pak ate gjuhe. Po te lexoj fjalet qe ka thene naten e pare, sic i kam shkruar , ne gjuhen e tij.

Ajo nisi te lexoje. Ate moment buzet e Xhinit nisen te leviznin. Sic duket i kishte mesuar permendesh ato fjale... pavaresisht se asnje prej tyre nuk e kuptonte. Pastaj Rozi nisi te perkthej:

-Mos...te...ke.qinj... vrisn...mos!.

- Ketu Rozi nuk ka asgje, tha Xhini. Ai ka folur ne gjume.

-Xhin a te ndodhet ndonje laps?.

-Po.

Ajo e mori dhe nenvizoi fjalet.

-Xhin, shiko! Mendo se nje femije normal nuk do te fliste aspak keshtu.

-Ku te vete mendja Rozi!..ia ktheu ai si me zili.

-Te thashe, mendihmoi Meri.

-Por Rozi s' mund te themi ekzaktesisht qe atij i ka humbur kujtesa.

-Sigurisht kur te zgjohet do ta pyes. Por ama degjo fjalen time. Ve doren ne zjarr nese ai femije nuk ka pesuar gje.

-Mire, mire po iki tani.

-Prit!

Xhini buzeqeshi dhe menjehere u kthye nga ajo :

-C' do Rozi.

-Harrova te te them dicka. Une tani do te iki. Turni i nates mbaroi. Te lutem shume meso ta pyesesh femijen per emrin ne gjuhen e tij.

-Ne rregull.

Rozi ia shqiptoi ndalngadale ate pyetje deri sa ai e pervehtesoi. Xhini ndejti prane femijes , qe akoma flinte. Asnje tjeter nuk kishte ardhur. Heshtja tani po e rendonte shume Xhinin. Aq me teper qe nuk mund

te duronte dot. Per te kjo ishte nje torture e vertete..

Po rrinte me koken ulur si zakonisht dhe me nje dore te mbeshetur mbi faqe. Balli i tij e kishte humbur lemueshmerine e meparshme, nga disa rrudha si ne balle ashtu edhe ne pjeset afer buzeve, gje qe atij nuk i shkonte aspak. Xhinit nuk ia kishte shume qejfi te rrinte ne nje vend. Here ulej, here ngrihej, duke ecur ngadale rreth shtratit te femijes. Nganjehere i hidhte nje veshtrim trupit imcak, qe rrotuloheju majtas dhe djathtas pa vetedije. Akoma asnjeri nuk kishte ardhur. Kjo gje e acaronte se tepermi Xhinin.

-Ej!

Femija ishte zgjuar dhe po e shikonte doktorin me kureshtje. Madje nisi edhe t'i buzeqeshte, a thua se njiheshin prej kohesh.

-Ucove me ne fund?! Sic e sheh vetem une jam prane teje.

Femija qeshi. ajo fytyre i kujtohej gjithnje. Nje fytyre e skuqur e rrethuar me floke te zinj te ngjitur si iriq, e cila menjehere i kishte terhequr vemendjen disa dite me pare. Xhini po e veshtronte me seriozitet duke menduar:

-Sa i vogel qe eshte! Ky do te jete shkaku qe qesh pa kuptim.

-Ej, ej... thrriti femija. Xhini ktheu koken perseri. Ne.

koke i sillej si vorbull fjala e Rozit, keshilla e saj:

"Pyete, pyete, pyete!"

Xhini nuk priti me, po iu afrua femijes dhe filloi t'a pyes duke shqiptuar me veshtiresi fjalet

-Si e ke emrin? (gjuha qe fliste femija ishte gjuha shqipe) Femija shtangu kur degjoi ato fjale, ne gjuhen e tij. Per ta kuptuar e kuptonte, por per t'u pergjigjur jo. Cuditerisht ate moment emri si kujtohej. Sforcohej se tepermi, luftonte, por emri si kujtohej. C'fare t'i thoshte atij njeriu, para tij, kur nuk dinte si t'i pergjigjej. Mu ne majete gjuhes e kishte emrin dhe nuk e shqiptonte dot. I lodhur nga ai sforcim i tepert, pa rezultat, femijanisi te qaj paze. Xhini iu afrua menjehere, duke mos ditur shkakun e vertete te atyre loteve :

-C'fare ke? Te dhemb gje?

Femija me sy te perlotur degjonte. Por nuk kupotonte gje. Xhini iu drejtua , duke perseritur me veshtiresi pyetjen qe i kishte mesuar Rozi:

-Si e ke emrin?

-S' mundem!, ...iu pergjigj femija. Ate moment Xhini zgurdulloi syte nga ajo fjale, menjehere u ngrit nga shtrati i femijes, e u drejtua per nga telefoni. Rrotulloi duke memoritur numrin e Rozit: U degjua nje ze i holle vajze.

-Kush jeni?

-Xhini.

-Xhin!. Pate fat se tani sapo erdha. C'ka ndodhur?

-E pyeta Rozi femijen dhe mu pergjigj.

-Ashtu? ... therriti Rozi... Si e kishte emrin?

-S'mundem.

Rozi nisi te qeshte.

-Rozi! C'pate moj?

-Xhin, ai s'te ka thene emrin.

-Si?

-Femija te eshte pergjigjur se nuk mund te t' a thote dot emrin.

-E c' faj ka qe e mora si emer? **Mire**, mire, mirupafshim Me te shpejte mbylli telefonin. **Ishte** teper i merzitur Profesori ate moment sapo kishte **hyre**.

-Miremengjes, profesor.

-A ka ndonje gje te re? ..pyeti **profesori**.

-A vini pak me mua? ..i tha **Xhini duke e marre per krahu**.

Te dy u ulen ne krevatin perballe femijes. Xhini tregoi te tera. Ate mengjes pofesori kishte hyre me qejf. Por ne fund te bisedes fytyra e tij u venjt.

-C' do bejme? ..ia ktheu **Xhini**,

- Tani asgje, **pak me vone ku te vijne te tjeret do ta diskutojme**.

Problemi u diskutua edhe me te tjeret. Se fundi te tere dolen ne konkluzionin se vetem Rozi mund te komunikonte me te. Ceshtjen e kujteses ia lirin ne

dore psikoanalistes Meri Gleiz, shoqes se Rozit. Doktoret u shperndane paksa te cuditur kur moren vesh qe ai ishte i huaj, e pikerisht shqiptar. Franca nga Shqiperia nuk ishte larg. Per kete vend te vogel kishin degjuar. Thoshin qe ishte nje vend misterioz, i panjohur dhe i izoluar. Edhe gjuha e tyre ishte e veshtire si vete ai vend. Dhe femija ishte pacient teper i veshtire..

Orari i paradites ende nuk kishte mbaruar, kur vune re qe dikush po zbriste shkallet teper ngadale. Ishte Xhini. Dukej se dicka po mendonte. Doli nga spitali dhe u drejtua per ngaklubi i Mishelit. Sa hyri brenda klubit i doli nje mesogrua me floke te gjate, me fytyre thatanike e me ca sy te vegjel ngjyre te kalter. Ate moment Xhini kerkoj te largohej, por ndali kur degjoi qe e therriti Misheli. Mbasi vuri re se Xhini nuk po levizte nga vendi iu afrua me te shpejte:

-C'te ka ndodhur? ..e pyeti Misheli duke e marre per krahu.

-Mire, mire t'a tregoj, vec mos u merzit.

-Pa he te te degjojme.

Keshtu nisi ajo bisede, si ne spital. Por kesaj radhe ai e tregoi shume shkurt Me ne fund **Misheli e mori vesh se cili ishte shkaku i asaj zymtesie qe e kishte pushtuar.** Ai ishte i merzitur se nuk po jepte "ndihmesen" e tij per femijen.

Por Misheli bullafiq nuk e la te mendohej mendohej gjate duke i thene:

-Degjo Xhin, do te te bej nje pyetje. **Vec mos ma merr per ters.**

-Pa he!

-A merr vesh, a merr vesh nga punet familjare?

-Si te tere.

-Pa ra disa ditesh keni biseduar per ceshtjen e familjes se femijes, e cila tani per tani eshte nje gjilpere ne kashte. Une te propozoj qe te jesh t'i ai qe te zbulosh se ku eshte fshehur gjilpera. Keshtu edhe ti do te jkapesh kontributin tend.

-O c'mrekulli! i tha i lumtur Xhini Mishelit.

-C'kenderment te **besh**?... e pyeti Misheli, kur e pa qe po ngrihej.

- Do te shkoj tek nje mik per t'a pyetur per ate ceshtjen... vazhdoi ai duke i shkelur syrin.

Per cudi ai ndrroi **ruge**. Shkoi ne shtepine e tij per t'i renditur tere ato mendime. Ai ishte nje tip, qe gjerat i bente me plan. Dhe me qe te nesermen ishte e shtune, dite pushimi, takimin me ate shoke e la per te nesermen. Mbasi shkroi dicka ne bllok ai u shtri dhe e zuri gjumi.

Rozi Fleiger mbasi kishte fjetur dy tri ore ishte

ngritur. Ishte veshur dhe ishte drejtuar për nga Meri. Sigurisht kete gje e bente, sepse kishte nevojë për te. Pas pak ajo u gjend para apartamentit të saj.

-Bonjour mon ami... e pershenderti Meri po sa e pa që hyri.

Meri ishte cuditur nga vizita e saj. Shume rralle ajo vinte tek ajo. Shtepia edhe brenda ishte e madhe. Dhe kudo që të hidhje syte do të vereje tablo teper të bukura. Me ato ajo gjithnje kënohej. Jo vetem që ishin origjinale, por ishin të piktoreve të njohur. Kudo të binte në sy ngjyra e kalter. Aq sa dukej se edhe syte e saj kishin marrë një hije kalteroshe.

-Rozi, sot në klub pashe Xhinin

-A të tha ndonjë gje?

-Jo. Nderroi drejtim. Ti e di se në të dyjemi zene dhe ai ende nuk më ka folur.

-S'prish punë. Kam një lajm që besoi do të të interesoi.

-C'fare lajmi?... pyeti me kureshtje Meri.

-Sot është vendosur se une dhe ti të merremi me ceshtjen e atij femijes shqiptar.

-Sa mire, ndonese jam e zene do të interesohem për te... tha duke ulur koken pastaj vazhdoi... e pranoi me deshire.

Biseda u ndërpre kur ra zilja.

-Kush mund të jetë?... pyeti Rozi.

Meri e pa fytyrën kureshtare të të shoqes dhe buzeqeshi.

-Eshte im shoq. E njoh nga dora...tha nderkohe, qe po drejtohej me nxitim nga dera. Per balle u shfaq nje njeri i gjate, shpatull madh dhe me nje veshtrim teper enigmatik. Asnjeri nuk mund t'i rezistonte atij veshtrimi. Rozi sa e pa uli syte, kurse Meri po e veshtronte me kureshtje sikur donte ta pyeste. Sa e pa Rozin buzeqeshi lehte, duke pershendetur me miresjellje, duke u ulur ne nje kolltuk prane saj.

-C' te reja kemi nga spitali?

-Asgje...i tha **Rozi me syte pertoke dhe nderkohe u drejtua nga Meri:**

-Meri kur te takohemi neser?

-Si gjithnje fiks ne tete, ne spital...ia ktheu Meri

-Po ju te policise si ia kaloni?...e pyeti pas nje minute heshtje Rozi.

-Mire

-Ah, mire neser, ne tete, peshperiti ajo dhe u begati te ngrihej.

-Rrini dhe pak. ti s'ndejte shume...i tha si me keqardhje Meri.

-Jo dhe kaq boll. Mirupafshim.

-Prit te pakten te te shoqerroj.

Tek dera ajo e pyeti prape **Rozin:**

-Kush vendosi qe une te ndihmoja ne ceshtjen e femijes.

-Se di. Une nuk isha aty.

-Po nga e more vesh?

-Nga xhaxhai

-Po ai nga e mori vesh?

-Nga Xhini...tha Rozi -**Ah, keshtu na qenka puna.**
Prandaj i pash sot te dy ne klub. Mire,
mire,mirupafshim.

Rozi mbasi u pershendet u largua. Ngriti koken nga
qielli dhe vuri re se ai ishte i erret. Pikerisht ate
moment ajo ndihej e merzitur. Qielli i Dukej si nje
shok qe i ndante hallet me te. Do te kishte deshire te
rrinte edhe nje cike me Merin, por prezenca e atij burri
shtatlarte e rrenqethte. Dicka i kujtonte nga jeta e
saj Askush nga miqte e saj nuk e dinte pse ishte aq e
mbyllur. Kur ngriti per se dyti koken, disa pika i rane
ne fytyre. Ngriti doren per t' i fshire dhe nxitoi hapat. Por
shiu filloi me vrull, aq sa kur arriti ne shtepi ishte bere
qull. Uji i kishte hyre deri ne palce. Pas disa oresh
filloi te teshtinte dhe pati temperature. Per t' u qetesuar
u shtri duke menduar per femijen , por edhe per
Xhinin.

Xhini flinte aq shume saqe gjithnje e gjeje me sy te
erret. Cudi si nuk vinte dhjame; kishte ngelur thatim
me fare pak bark. Syte i kishin ngelur te perqendruar
tek nje liber, te cilin e kishte lexuar para pak kohesh.

Sapo ishte gdhire. Shiu kishte pushuar dhe qielli ishte i kthjellët. Dielli ende nuk kishte aguar, kur Xhini ishte ngritur. Syte e tij drejtohen për nga dera. Ajo që kishte tërhequr vëmendjen e Xhinit ishte gazeta e mëngjesit.

Emori, e veshitroi, e shfletoi por nuk e pame themel. Beri tamam si femijte e vegjel, që shohin figurat dhe thone me krenari... "e lexova". Edhe ai pasi "e lexoi" u ngrit dhe e vendosi me ngadale në një raft ku ishin stivosur shumë e shumë të tjera. Sic duket tek Xhini po shfaqej talenti i koleksionistit.

-Sot e kam ditë pushimi. foli me ze të ulet Xhini, dhe mbasi tha kështu u vrenjt. s' duhet t'ia lejonte kurresesi që të fliste me veten. Hodhi veshtrimin tek ora dhe vuriu re se ishte shtatë e gjysëm. Për të ishte shumë heret, por megjithatë u ngrit dhe u vesh duke bërë gati që të dilte. Desheronte të shkonte në klub për t'u argetuar. Zymtesia e djeshme e kishte dermuar. Filloi të ecte me ngadale duke shikuar here majtas, here djathtas. Nuk kaluan as 5 minuta kur jo shumë lart tij vuri re Rozin, që nxitonte. Ai e dinte fare mirë që Rozi e kishte marrë vesh punën e djeshme. Ai desheronte të bisedonte me të. Ishin apo nuk ishin miq menjëri tjetrin. Por sa u bë gati t'a therriste degjoi zerin e njohur të Merit. Kështu, që ai hoqi dorë nga biseda me Rozin. Mbasi i humbi nga syte që të dyja, nisi të ecte

qetesisht, duke shikuar qytetin me nje kenaqesi te madhe. Sigurisht per te ai ishte teperi bukur e sidomos ne nje dite si ajo. Sa romantike do te ishte sikur te kishte shetituar pak me Rozin!

-Kemi nderin t'ju pershendesim, zoti Xhin!... tha me te shpejte dhe teperi i gezuar Misheli sa vuri re se ai po vinte.

Misheli si gjithnje e kishte pike te dobet Xhinin. Shkaku... ishte shakaxhin si vete ai.

-Miresetegjeje, kampion shendeti!... im tha si pa te keq Xhini.

-C'deshironi?... e pyeti me miresjellje, Misheli.

-Nje gote uiski.

Misheli filloi te qesh.

-Xhin, a shkove dje tek zoti...?

Xhini sa degjoi ate pyetje u gerlltit. Sa tur t'i dilte genjeshtra. Ai s'e kishte zakon, por ja qe....

-Nisi shiu dhe s'shkova dot... tha Xhini duke u menduar. (ja nje genjeshter tjeter).

Xhini e dinte fare mire se Misheli ishte i zgjuar sa ishte i shendoshe, prandaj nuk ndejti shume dhe u largua.

Pasi u largua nisi te shetiste duke menduar planin e dites. Hodhi syte prap tek ora dhe vuri re se nje goxha

kohe e kishte kaluar ne klub. Ishte ora 10. Mendoj te shkonte tek shoku i tij i ngushte, por kujtoi se ai mund

te ishte ne pune. Filloi te ecte ngadale, ne trotuar, kur

iu kujtua se zoti Zhan Gleiy ishte pushim. Pa nguruar u drejtua nga ai sepse e dinte qe Meri nuk ishte ne shtepi, por ne spital me Rozin. Pas pak ai u gjend perballe asaj dere te madhe, qe shume kujt i bente pershtypje. I ra ziles disa here. Dhe kur shpresat i kishin humbur, degjoi disa hapa te ngasdalte. Dukej se padroni i atyre hapave ecte me pertese.

-Ah! Xhin! hyr!

U habit se tepermi nga vizita e Xhinit. Madje po e shikonte me vemendje a thua valle se do te zbulonte ndonje lajm ne ate fytyre.

-Ulu!

-Mos te zgjiova nga gjumi?... e pyeti me keqardhje Xhini.

-Jo, vec se kisha nje dhembje koke. As vete nuk e di se si me nisi.

Xhini i hodhi nje veshtrim te terthorte, nderkohe qe dora e tij, dic po kerkonte ne xhep. Ishte nje xheq i vogel sa dy gishterinjte mund te futeshin me zor ne te. Me ne fund ai buzeqeshi duke nxjerre nje kuti. Ai i zgjati doren atij burri shtatlarte, i cili ishte kerrusur duke mbeshtertur duarte mbi koke.

-Urdhero, pi nje koker qe te qetesohesh... i tha Xhini.

-Faleminderit. Kushedi sa ju rendojne xhepat ju doktoreve nga ilacet qe mbani...

Pasi tha keshtu ai hodhi veshtrimin nga xhepi i

Xhinit. Veshtrimi i tij u perqendrua tek ai xhe dhe buzet u perdrodhen. Ai s'e besonte dot se gjithë ajo kuti ilacesh kishte dale nga ai xhep mikroskopik. Heshtjen e theu zeri i Xhinit.

-Zoti Zhan kam ardhur per nje pune teper te rendesishme.

-Si eshte puna?.. i tha, Zhani duke u perqendruar me forte.

-Eshte fjala per ate femije, qe shpetoi nga aksidenti. Ai tani eshte jashte rrezikut, por ne lidhje me familjen e tij, ende nuk dihet gje... Pasi hodhi nje shikim tek shkresat afer raftit vazhdoi... Me sa di, ju ishit prezent, kur ndodhi aksidenti. A mos valle dini gje?

-Po. Une isha atje ku ndodhi aksidenti. Nese te intereson kaq shume, do te pyes dhe do te jap pergjigje.

-Kur?.. pyeti paduruar Xhini

-Mbase nese. Por te jesh i sigurte se kjo pune duhet te jete kryer. Une di vetem numrin e targes. Po te duash ta jap

-Edhe pyet! Mua cdo detaj me intereson shume.

Xhini bisoi per femijen dhe kjo bisede i hengri nje pjese te mire te kohes. Dielli si nje sy gjigant levizte me qetesi dhe futej ne cdo qoshe. Xhini shikoi qiellin dhe nje ndjenje e cuditshme e pushtoi. Ata ishin mikroqenie ne ate pafundesi. Dhe kjo mikroqenie, Xhini, do te jepte nje mikrondihmese ne

lidhje me nje mikroqenie tjeter. Sa i parendesishem i dukej vetja para asaj pafundesie te mistershme.

-C'po mendon?...pyeti Zhani duke buzeqeshur. Sic duket dhimbja e kokes i kishte pushuar.

-Hic. Vetem se per nje gje kaq te vogel duhet te lodhesh kaq shume.

-Pse pune e vogel te duket kjo ty?

-Nejse, nejse. Mendoi se u be vone.

AH, ju doktoret sa uleni ngriheni. Te terenjesoj jemi.

Dhe Rozi qe erdhi nuk ndejti fare.

Xhinit ate moment sesi i erdhi. Ndoshta u kenaq nga komplimenti, qe i beri zoti Zhan. Njesoi si Rozi.

-Degjo Zhan. Gruas mos i thuaj per ate qe biseduam bashke.

-Perse?...tha si me habi ai. -E di si eshte puna? Gruaja jote, Meri, eshte shoqe me Rozin. Dua qe kjo ceshtje te me ngelet mua per ta zgjidhur. A me kupton?

Zhani buzeqeshi dhe pohoi me koke. Por te themi te drejten ai asgje nuk kishte marre vesh.

Nderkohe qe Xhini po shetiste Rozi me Merin u drejtuan per nga spitali Femijen e gjeten zgjuar. Menjehere nisen ta pyesin. Rozi kryenterolin e perkthyeses (te cilin ajo e pelqente shume), ndersa Meri ushtronte profesionin e saj te vertete. E

rendesishmja ishte qe puna po shkonte mjaft mire.

-Cfare eshte kjo ketu?...e pyeste Rozi per objektin qe i tregonte.

-Nje kafshe!...pergjigjej femija duke buzeqeshur. Me ne fund nje person fliste ne gjuhen e tij.

-C'fare kafshe?...vazhdonte pyetja.

Ate cast fytyra e njome e femijes u rrudh si fytyra e nje te moshuari. Dukej qe po mundohej. Syte e tij leviznin pareshtur terte frike. Ata shprehen dicka para se goja te fliste. Duke pare kete gjendje Meri menjehere u ngrit dhe shpejtoi per tek canta. Duarte sajte sprovuarã, e hapen shpejt dhe prej andej nxorren nje objekt. Ishte nje format ne te cilen ishte vizatuar nje gjel.

-Pyete femijen Rozi!...iu drejtua me nje ton urdherues dhe si me frike, Meri.

Ata sy te pafajshem ia copetonin zemen me dysh Rozit. Ate cast zgjati doren dhe e perkedheli Femija u drodh. Ishte hera e pare qe po e perkedhelnin. Veshtrimi u perqendrua tek ata sy misterioze. Femija buzeqeshi. Por kjo nuk vazhdoi gjate, sepse nje dhimbje si shpate i shpoi kraharorin. Por ai duroi duke shtranguar dhembet e vegjel, e nderkohe nje pare syte pyetes te Rozit.

-Meri!, shiko femija po qan...thasi me frike Rozi pasi vuri re se detyrote rreshqiten ne syte e tij.

-Mbase u merzit qe po e pyesim shume. Por s'kemi

c'bejme. Vazhdo!

-Po ai po qan?!

-Le te qaj!

Ate moment Rozi pa si me frike edhe shoqen .Valle kaq e eger ishte ne zanat?, dhe nderkohe iu kujtuan fjalet e nje kolegu te saj.Gjermanet jane te eger kudo.Sigurisht Meri nuk ishte .gjermane po kishte studiuar atje.Ndoshta kjo kishte ndikuar tek ajo per t'urreptesuar.

-C'fare eshte kjo?...pyeti pa pertese Rozi

-Kafshe!..u pergjigj femija

-C'fare kafshe?

Asnje pergjigje. Ne vend te saj vetem disa pika lot.Femija i pa me frike.I vinte inat qe po lodhej dhe emri i kafshes s'i kujtohej."C'dreqin kam keshtu"...mendoj.

Femija veshtrou nga Rozi dhe tha

-Ki..ki..ki

-Si e ka emrin?...pyeti me shpresa Rozi

-S'mundem

Rozit ate cast iu kujtua Xhini. Here i jepte te drejte, here jo.Filloi te qesh.

-C'ke qe qesh?

-Hic!,

-Degjo ketu.Ec dalim pak jashte...i tha me qetyesi Meri.

Ato dolen. Te dyja po ,ecnin gadale. Mengadale po ecte Meri, dicka po mendointe. Pas pak ajo iu kthye Rozit duke i thene:

-Degjo ketu. Tani jam mese e bindur se femija ka humbur kujtesen.

-Teteren?... pyeti e tmerruar Rozi

-S'besoj. Mbase pjesisht. Por dije se per te nxjerre nje perfundim te sakte duhet pune.

-Sa?

-Shume dite. Me te vertete eshte pacient shume i veshtire.

-Une jam gati!

Mire, mire! Shkojme tani te pijme nga nje kafe. He, si thua?

-Ne rregull.

Te dyja krah per krah u larguan. Shiu kishte pushuar.

Xhini kishte mberritur ne shtepi dhe po rrinte si i humbur ne nje kolltuk. Syte e tij nganje here shikonin nga dritarja. Qielli ishte i kthjellet. E pikerisht me te po zemerohet. Nuk perputhet kjo atmosfere me gjendjen e tij. Kishin kaluar 20 ore kur u nda nga Zhani. Mezi priste qe ai t'a merrte ne telefon sic e kishte lene. Prandaj dhe shikonte here pas here telefonin me inat, sikur ai te ishte ndonje armik. Kaluan edhe disa

minuta dhe se fundi momenti i shumepritur erdhi. Zilja ra. Ajo pati nje efekt te menjehershem tek Xhini, i cili u hodh perpjete. Mori telefonin dhe filloi te fliste: - Alo! Shyqyr qe more se ma plase shpirtin. Kam tere naten qe per ty mendoj. C'bere per ate qe biseduam. Do te ta di shume per nder.

-Xhini ju jeni?... u degjua ne anen tjeter.

Ate cast Xhinit sa nuk ira telefoni nga dora, kur degjoi zerin e profesorit. Cuditerisht fytyra e tij u skuq, dhe sa ha e mbyll syte i kerkoi te falur profesorit:

-Profesor, me falni, kujtova se ishte Zhani.

-Te mora per te pyetur ne e di adresen e Merit?

-Po, shenoni!

Me ne fund biseda midis Xhinit dhe profesorit perfundoi. Keshtu qe Xhinit i duhej te priste zile tjeter. Por cdo durim ka nje kufi. E per te kishte kaluar me kohe. Ungrit, doli. Vetem se tani nderroi drejtim, per nga rajoni i policise. U fut brenda dhe se largu njohu fytyren serioze te Zhanit, i cili ishte perqendruar mbi nje grumbull letrash. Shpejtoi hapat dhe menjehere i foli:

-Si shume u vonove, Zhan!

Zhani ate moment, ngriti koken dhe e veshtrou me qetesi.

-Me ate po merrem... ia ktheu ai, dhe perseri uli koken duke vazhduar...

-Prit pak!

Xhini iu afrua. Dalengadale ajo heshtje e shokut po e merziste. Sigurisht kur ai vete nuk kishte me c'fare te merrej. Ngriti koken dhe nisi te shikonte tavanin e bardhe, dyshemene e mermerte e keshtu me rradhe gjer sa arriti tek shkresat afer tij.

-Zhan, ke dheshume?.. vashdoi Xhini

Pikerisht ate moment fytyra serioze e Zhanit u cel. Ai ngriti koken drejtuar Xhinit:

-Me ne fund e gjeta! Nuk besoja.

-C' gjete?

-Dicka lidhur me aksidentin. Ne gazeten "L'Esperance" te dates 10 eshte botuar nje artikull per kete aksident.

-Ne gazete?.. pyeti me zete ulet e teper ngadale Xhini i menduar... Per c'fare behej fjale?

-Me vjen keq, por ai miku qe e kishte, dje nuk ndodhet ketu.

-Megjithate faleminderit.

Mbasi e pershendeti ai u largua me nxitim. I mbeti ne mendje se per cfare mund te ishte shkruar n'ate gazete. Nga nxitimi Xhini desh u perplas me nje grua.

-Per ku nxiton keshtu Xhin?. Kur ktheu koken u shtang. Ishte Rozi.

-Po ti ketu?.. e pyeti me miresjellje Rozin ai.

-Po shkoje ne spital, do te vish?, ndonese e di qe eke

dite pushimi.

Ai desh te thoshte po, por pikerisht ate moment iu kujtua gazeta.

-Me vjen keq, por nuk mundem.

Rozi e veshtroui me cudi. Gjithnje kur i kerkonte ndonje gje ajo, ai e bente. Kurse sot ndryshonte.

Te dy u ndane nga ai takim krejt i papritur. Nderkohe Xhini kishte nisur te ecte me aq nxitim sa gati vraponte.

Shume kush mund ta merrte per sportist.

Arriti. Hapi deren me shpejtesi dhe u turr per nga gazetat. Per nje cast nguroi, kur pa gjithje ato gazeta.

U ul ne kolltuk dhe nisi t'i shfletonte.

Kaluan ore ndoshta dy, por se fundi kerceu.

-E gjeta!

Syte e tij u ndalen ne nje foto ku ishte nje makine qe kishte marre flake me titullin: "Nje aksident ne kufi".

Kjo eshte, mendoi me vete i kenaqur Xhini. Filloi te lexonte.

"-Nje aksident ndodhi dje ne kufirin...."

Per nje cast veshtrimi i tij u perqendrua ne nje fjale "milioneri". Kjo e turbulloi teper Xhinin. U gellitit disa here, ferkoi syte por perseri "milioneri". Valle

c'lidhje kishte midis femijes dhe "milionerit"? Ne

makine ishin dy persona: nje burre dhe nje grua. Burri na dilka milioner!. Mos valle milioneri na dilka i jati

i femijes? Po sikur kjo te ishte e vertete. Fytyra i

shkelqeu .Kishte rene ne gjurme te familjes se femijes.
Ai po behej nje person i rendesishem. Kerkimet duhej
te vazhdonin.

Ndodh ndonje here qe kur kerkon zgjatje kohe, ajo si
per dreq ecen shpejt ose e kunderta. Pikerisht ashtu
po ndodhte ate vit. Nderkohe qe Rozi me Merin
merreshin me femijen, Xhini zbulonte enigmen familjes.
Te dy palet desheronin ato momente nje zgjatje te
kohes. Por ja qe koha nuk ju bindej. Ajo ecte me te
shpejte, duke lene gjurme te lehta ne rrjedhen e
ngjarjeve. Kishte ardhur dimri. Zakonisht ai nuk vinte
i ftohte, por ja qe kete vit ndodhi ndryshe.

Xhini teshtiu. Ai ishte teper i ndjeshem ndaj te ftohtit.
Edhe ate mengjes dimeror teshtimat nuk po e lihnin
rehat. Miqesia midis Xhinit e Rozit ishte rritur e
forcuar shume. Xhini kete miqesi e shihte me sy tjeter,
nderkohe qe me Rozin nuk ndodhte ashtu. Per te ai
ishte nje kolet pune, thjesht simpatik. Rozi e mendonte
e thoshte. Nje dite i kishte thene:

-Xhin, ti je kolegu me simpatik i spitalit.

I shkreti Xhin, vetem prej kesaj fjale ndejti nje dite pa
gjume. Atij i vinte cudi me veten. Duhej te ishte i
kohes, i shkathet. Por ja si per ters, fjala i ngecte ne
gryke perpara veshtrimit te sinqerte te Rozit. Me

perpara ai ishte i bindur, qe Rozi ishte e lumtur dhe nuk njihnte vuajtje. Keshtu mendonte Xhini per Rozin, por ky mendim ndryshoi. Ai kishte vene re ne disa raste qe Rozi qante. Kjo Dukej nga syte e skuqur. Atij vete i vinte shume keq dhe here pas here qortonte veten per c' kishte menduar me pare per te. Rozi sa e shihnte, buzeqeshte dhe mundohejt i fshinte lotet. Por per fat te keq lotet lene gjurme. Ato castë Xhinit i vinte ta perqafonte, e keshtu bente nje rruge e dypune. Por ja qe s'guxonte. Nderkohe qe miqesia e tyre forcohej, puna vazhdonte me ritmet e saj.

Mendoj qe koleget e tij duhej ta merrnin vesh menjehere punen e aksidentit misterioz. Duhej patjeter qe ata te dinin dicka, dhe mbi te gjitha Rozi. Vec se tani me te nuk ndodhte asgje. Ajo pershkonte po te njejtin itinerar, e heshtur si gjithnje, me po te njejtin sinqeritet. Madje kohet e fundit syte e saj vezullonin **si diell, gje qe ia bente te veshtire**. Xhinit komunikimin. Sec kishte ajo ato dite! Ecte e lumtur, a thua se trupi nuk i peshonte. Qeshte ne heshtjen e saj. Xhini ishte i sigurte se mendja asaj i shkonte diku, aq sa ishte i sigurte se per ate nuk kujtohej me. Por edhe ai mundohej ta ruante humorin perballe koleges se tij. Nje here kish tentuar ta pyeste por guximi i duhur i mungonte dhe keshtu ai e la per nje here tjeter.

Ne korridorin e gjate e te bardhe ndiheshin hapat e lehtete Rozit. Ate dite ajo Dukej e lumtur. Here e gjej nga njera ane e korridorit, here tek tjetra.

-Xhini, ec pak te tetregoj dicka!..tha me nxitim Rozi, duke e veshtruar me nje buzeqeshje te embel.

Xhini e shikoi me kujdes fytyren e gezuar te Rozit. Dukej me te vertete sikur ajo i kishte lexuar ato caste mendimet e tij. Kjo gje si pelqeu aspak Xhinit. Ky ishte shkaku qe Xhini buzeqeshjes se saj te sinqerte ia ktheu me nje veshtrim mjaft serioz. Dhe sic ishte uli koken poshte Kembet e tij nisen te leviznin pa deshire. Te dy po ecnin ngadale. Ndonjehere Rozi e shikonte terthorazi. Kete gje Xhini nuk e verente aspak. Shikimi i tij ishte drejtuar nga kembet. Ishte hera e pare qe ai Dukej sikur i kercenonte. Me ne fund ata arriten prane salles, ku rrinte femija. Xhini e kishte parashikuar se ku do t' a shpinte Rozi. Ato ditet e fundit femija ishte ne qender te bisedave te saj.

Ai shikoi rreth e rreth salles, veshtrimi i tij u ndal tek nje njeri i vogel, qe po i buzeqeshite. Xhini shtangu per nje cast. Ktheu syte nga Rozi, sikur donte ta pyeste:

-A eshte me te vertete ky, femija i ngritur ne kembe?
Rozi sikur ta kuptonte pyetjen e tij i pergjigjej me nje buzeqeshje, te njejte si ajo e femijes.

Kete skene heshtjeje e theu e qeshura e papritur e femijes. E qeshura e tij e paster pushtoi tere sallën.

Nisi te qesh edhe Xhini edhe Rozi. Profesori qe kishte ndjere, qe lart te qeshuren e Xhinit nxitoi per ta ulur kete potere. Por e papritura e pushtoi edhe ate kur pa femijen ne kembe

Femija kishte nje kohe te gjate, qe nuk ecte. Kembet i rrinin te mpira, sikurt i kishte te paralizuara. Rozi, si nje doktoreshe me durim, ishte e bindur, qe kjo gje do te kalonte. Ajo kishte kohe qe si nje nene e dashur, kujdesej per femijen dhe nxiste tek ai vullnetin. Ate vullnet qe mposhti gjithcka. Ishte pikerisht ky vullnet qe esheroi ate perfundimisht. Te dy ishin lidhur shume me njeri tjetrin dhe bashke kishin ndertuar kete mrekuulli. Lajmi u perha menjehere ne spital. Femija e vuri re kete gje dhe nisi te ecte. Rozi e ndiqte, duke u kujdesur qe te mos rrezohet.

-Rozi kam nje fjale me ty... tha Xhini, duke e shikuar me kujdes femijen nga koka deri tek kembet. Ende nuk e kishte marre veten. Ate moment vuri re kolegen e tij, qe dicka i tha femijes, i cili ngadale u drejtua ne sallen e tij.

-Per c'fare me doje?... pyeti ajo, duke levizur paksa koken.

-Degjo ketu. Kam nje lajm te mrekuullueshem. Po zbulohet se i kujt mund te jete femija.

-E c'dihet per kete?... ia ktheu si me tallje ajo.

Xhini e kuptoi, qe ajo nuk po e besonte pranda! afroi

koken duke vazhduar:

-Nje nga personat qe ndodhej me te ne makinen, qe u perplas, ishte milioneri Van Deli.

Syte e saj u habiten, por ajo u permbajt duke thene:

-Kjo eshte e pamundur! Xhini nuk po e kuptonte pse ajo u merzit. Per te ky ishte nje lajm i mrekullueshem.

-Te me falesh Xhin po une po iki, tha me gjysem zeri Rozi, duke u munduar te fshinte lotet qe i rrodhen ne faqet e lemuara si mermer. Ktheu koken nga ana tjeter dhe u largua per nga zyra e saj.

Artan ishte i bindur se dicka e padesherueshme do te ndodhte. Nisi te ecte neper korridorin e gjere. E nderkohe nisi te mendonte i frikesuar se cdo te ndodhte. Fatkeqesisht ai nuk kishte ndonje parandjenje te zhvilluar. E keshtu sic ishte, u drejtua per nga zyra e tij. Aty e prisnin pune te tjera. Mbylli deren dhe nisi punet e perditshme.

Duart e saj filluan te dridhen pikerisht ne momentin kur po hapte deren e zyres. Mbasija doli ne krye hyri me te shpejte brenda dhe nisi te qante. Nxori shamine, fshiu lotet por ata nuk ndalonin. Syte e saj te njomur nga lotet e tepert nisen te veshtronin rreth e rrotull dhe u ndalen tek nje portret mjaft i madh peisazhi. Sa shume e shume kujtime i sillte ai vend. Njelume i qete,

qe rridhte lehte, nje diell gjigant, qe fshihej mes maleve dhe nje vile e vogel ne mes asaj natyre perrallore. Kishte raste qe kur veshtrimi i saj ndalonte ne ate peisazh, pa pritur lotet pershkoniin fytyren e saj, a thua se ai peisazh fshihte ne vetevete dicka misterioze. A thua se ajo vile e pikturur dicka i kujtonte asaj. Syte e saj pershkuan fshehtazi portretin i cili i dhuronte vetem lot. Ajo tentoi edhe nje here te ndalonte lotet dhe besdoi se ja doli ne krye. Frika se mos femijen e largonin shpejt nga spitali e mundonte. Pa pritur nje buzeqeshje e lehte, e padukshme u shfaq ne buzet e saj. Filloi te mendonte:

"Asnjeri prej kolegeve te mi! Nuk e di se cfare fshihet ne portretin perballe meje. Mbi te gjithë Xhini, i cili me konsideron te lumtur pa vuajtje. Ai nuk e di dhe mbase s' do t' a marre vesh tragjedine time. Ate dhe une vete nuk dua ta tregoj. Thjesht nuk deshiroje. Vendin e Rolandit tim te dashur, askush nuk e zë dot. Sa keqjeta e tiju shua e me te edhe nje pjese e shpirtit tim. E pikerisht tashti qe ky shpirt po sherohej kerkojne prape ta plagosin. Pos heroehesha me te vertete, kur kisha prane femijen por kam frike se mos largohet nga spitali. Pse duhej te zbulohet kaq shpejt familja e tij? Dicka duhet te beje. Po ta kete te jatin milioner ate do ta kishin kerkuar me kohe? Jo, kjo nuk eshte e mundur!. Po sikur ai ta kete marre vesh te

verteten per femijen vetem tani?; atehere ate do ta nxjerrin shpejt nga spitali, nderkohe qe ai ka ende nevojte per mua. Jemi lidhur me njeri tjetrin e zorr se do te na ndajne kollaj”.

Ne cast nje zhurme u ndje ne korridor. U ngrit dhe hapi deren. Ishte profesori qe po qortonte nje nga infermieret. Shkakua ishte femija, i cili kishte dale, nderkohe qe infermierja nuk e kishte vene re. Nga xhestet e saj Rozi mori vesh se ajo mundohej te justifikohet. Iu drejtua profesorit, i cili sapo ishte ndare me infermieren. Syte e tij xixellonin dhe faqet i ishin bere prush. Ai nuk e duronte kurrsesi prishjen e rregullit.

Rasti esolli qe profesori, Xhini dhe Rozi te takoheshin balle per balle. E kur ndodhte kjo, nuk kishte zot qe te ndalonte diskutimet. Edhe ate dite nje diskutim i ri lindi, por jo ne spital. Koha kishte ikur me te shpejte dhe orari i punes se tre kolegeve po mbaronte. Te tre u drejtuan nga klubi.

-Miresenaerdhet, urdheroni!.. iftoi si gjithnje, Misheli.

-C’kemi, si dukesh me shendetin?... e pyeti profesori, duke e veshtruar drejt e ne sy.

-Me duket se kam shtuar nje kile dhe per kete jam krenar... iu pergjigj Misheli.

Ate moment Xhini afroi koken afer Rozit duke i

peshpëritur:

-Ve bast, qe Misheli i ka ngrene nje ose dy pula.
Rozi ate moment e veshtrou Xhinin me seriozitet,
ndonese i erdhi per te qeshur. Qetesine e castit e theu
zeri i Mishelit:

-C' deshironi?

-Skoc uiski!

Ai zgurdulloi syte, e duke veshtruar nga Rozi pyeti:

-Edhe ju?

Rozit ne fakt nuk i pelqente por ate moment ndjeu se
trupit ia kerkonte. Ishte e merzitur dhe mendoj se pija
do t'ia kthente humorin.

-Natyrisht xhaxha, ketu nuk ka ndonje te keqe...iu
pergjigj Rozi.

Misheli i hodhi nje veshtrim terthor profesorit per te
shikuar reagimin e tij. Por nuk vuri re ndonje mimike
te vecante tek ai. U drejtua per te kryer porosite qe iu
bene. Xhini e shikonte ende me keqardhje Rozin, e
cila ishte komplet ndryshe nga mengjesi. Tere ai gezim
ne fillim, u zhduk papritur. Dhe per kete gje Xhini
bente veten e tij fajtor. Desheronte ato momente, qe
ajo te qeshte.

-Urdheroni!, nderhyri Misheli duke vendosur 4 gota
uiski.

-Mishel! Ne porositem 3 jo 4

-Natyrisht por edhe mua me lejohet ta tok me miqte e

mi te afert. Mbi te gjitha me ty Xhin... e mbasi tha keshtu zgjati doren per t' a tokur goten e tij me ate te Xhinit, por goditja qe e forte dhe keshtu uiski doli me force nga gota e Xhinit. Fytyra iu sperkat. Ai nxorri shamine tere merzi, per t' u fshire. Kur ate cast ai u kthye dhe pa Rozin qe buzeqeshte. Nuk po u besonte syve. Por edhe ky cast kaloi dhe biseda mori ritmet e zakonshme. I pari qe e mori fjalen ishte profesori.

-Rozi, c' bete me Merin ne lidhje me femijen?

Rozi ate moment e kuptoi fare mire se ku donte te dilte profesori. Keshtu qe iu pergjigj shkurt dhe sakte:

-Besoj se mbaruam !

-C' perfundim nxorret? e pyeti Xhini.

-Mendojme qe kujtesa i ka humbur. Ky ishte shkaku, qe nuk kujton emrin e tij e shume e shume te tjera. Por mendoj se eshte nje femije inteligjent.

-A jeni e sigurte per kete? ..pyeti profesori

-Me se e sigurte, po te doni pyesni edhe shoqen time Meri. Mbase ajo jua shpjegon si psikoanaliste qe eshte, ia ktheu Rozi duke e pare me bisht te syrit. Edhe ajo dinte me se miri te fuste spica sikunder profesori. Kete gje e kishte deklaruar nje here edhe Danieli, i cili ishjte shprehur: "Rozi me profesorin jane dy rival te forte. Po te ndeshen asnjeri nuk del fitues." Profesori e kuptoi, qe me Rozin nuk hahej dot.

-Po per familjen dini gje?

-Me te merret policia..tha tere frike Rozi, duke dashur keshtu qe kjo bisede te mbyllej.

-Profesor nuk desheroja t'a hapja kete bisede, por meqe ra fjala..nderhyri Xhini

-T'a leme per nje here tjeter..tha si me lutje prape Rozi Xhini qe ate moment iu dha rasti te shprehte ate kujdes qe kishte treguar per ceshtjen e femijes nuk i perfilli fjalet e Rozit.

-Profesor te lutem me degjo!. Policia eshte marre me kete ceshtje si zakonisht. Njeri nga personat qe ndodhej ne makinen e aksidenduar, eshte i pasur, ndoshta milioner.

-C'fare?..iu mor goja nga e papritura profesorit, i cili u befasua...Pramilioner?...perseriti ai me vete. Sigurisht kjo, dicka sinjifikonte per fatin e femijes.

-Profesor, a ia leme policise me mire kete ceshtje?. Une desheroj qe femija te rrije me ne.

-E perse?. Ai tani gezon shendet te plote. Duam s'duam ne, policia do te merret me te heret a vone, ate do te vijne t'a kerkojne.

Biseda kishte marre vrull. Te tere ne ate tavoline bisedonin ne nje kohe. Fliste profesori, i cili ende i kishte syte e zmadhuar nga e papritura qe mesoi. Ndersa Xhini me humor te kthyer nuk e vinte re qe Rozi kishte marre nje pamje tepert te zymte, aq sa Dukej sikur nga casti ne cast mund t'ia plaste te qarit.

Por Rozi ishte aq e forte sa mund te perballonte cdo gje.

-E pamundur!. Sa here qe vini ketu ju flisni vetem per probleme pune. Ky eshte nje klub me fame dhe s'ju lejoj qet'a ktheni ate ne nje salle mbledhjesh... nderhyri papritur Misheli.

Ai kishte marre nje pamje serioze. Profesori e veshtrioi me kujdes Mishelin dhe i buzeqeshi. Fjalet e Mishelit, ate moment ishin thene me stilin e profesorit. Kjo gje atij i pelqeu. Misheli bullafiq nuk e mbajti per nje kohe te gjate, zemerimin. Pas pak nisi te buzeqeshte e te bente shakara.

Ungriten, e mbasi pershendeten pronarin e lokalit, u larguan per t'u takuar serisht te nesermen.

E nesermja erdhi me nje ndricim te vecante, te pazakonte per ate stine; por ajo dite ishte nje dite e zakonshme ne spital. Lajmi se femija mund te ishte femije milioneri u perhap s'rrufe.

Cuditerisht te tere doktoret, edhe ata te kateve me siper, qe me perpara nuk ishin interesuar per femijen 14 vjecar, tani u kujtuan per te. Dhjetra doktor u ngjiten ne pavionin e femijes per t'a shikuar ate. Nje skene e cuditshme, a thua valle sikur femija te ishte ndonje specie e rralle apo ndonje personalitet i larte.

Ja, qe thjesht nje emer te ndron pamjen, te nderron fytyren duke te bere simpatik perpara te tjereve. Edhe po te jesh i shemtuar ata thone se je nje yll; po te jesh ishkujdesur ata thone se je elegant. Dhe keto lavderime shtohen ne raport me poziten qe ke. Dhe ja lajmi e kishte kthyer femijen ne nje bir milioneri, pa emer por me pozite. Profesori, Rozi, Xhini e Danieli rrinin e shikonin ne heshtje doktoret qe zgjasnin kokat per te pare femijen. Madje profesorit i vinte kenaqesi kur shihte gjithë ate interes. Femija rrinte shtrire. Prane tij qendronte e zhytur ne vetvete Rozi. Thelle ne shpirtin e saj ishte hapur nje pus i thelle merzije. Femijahidhte syte rreth e qark si me frike duke shikuar ku ekundonje fytyre te re. E cdo fytyre ai ishte i detyruar t'i pergjigjej "Bonjour".

Ai kishte mesuar shume fjale franceze me ndihmen e Rozit, aq sa ishte ne gjendje qe te komunikonte pak ne ate gjuhe. Fatmiresisht vizita e doktoreve te tjere nuk zgjati shume. Ata u larguan mbasi shuan kureshtjen. Puna filloi perseri ate dite te mrekullueshme. Kurse femijen e zuri gjumi. Ishte nje gjume i lehte, i embel, i cili gjithnje femijeve u sjell endrra. Nje enderr e cuditshme u shfaq: "Nje burre shtatlarte, me sy te ashper, qe vezullonin ne diell, i doli perpara e i zgjaste duart e tij te forta. Dhe po ate moment ashpersia e tij u zbut. Goja e tij dic peshperiti me nje ze te

madherishem...bir!..Kurja, papritur ai u be me krahe dhe nje fantazme u end ne qiell derisa u zhduk si nje engjell. E nderkohe nje re e zeze arriti e me duart e saj ajrore kerkoi qe ta rrembente. e se fundi reja e zeze u largu duke kthjelltesuar qielli...Papritur ai u gjend mbi nje re. U frikesua e nisi te therras..Me zbrisni!, me zbrisni! Do te rrezohem....”

-C'ke i dashur. Jam une ketu...foli me te shpejte Rozi , e cila e vuri re qe femija po renkonte, duke levizur sa njeren ne tjetren ane te krevatit.

-Ku jam?...tha ende i pergjumur femija. Po dridhej.

-He zgjohu! Ishte vetem nje enderr. He, pra , zgjohu!..tha prape Rozi duke e perkedhelur me dhembshuri. Syte e femijes shkelqyen nga nje drite falenderimi. Zgjati doren e tij, e kapi ate te Rozit.

Femija po e shikonte me dashuri Rozin dhe e kuptoi. Prandaj nisi t'i fliste lehte e ngadale, duke levizur me njeren dore floket e gjata te saj.

Nganjehere femija i thoshte: “S'te kuptoje”. Dhe ajo nuk merzitej por ja perseriste perseri. Kishte kalua nje pjese e mire e kohes, ku u degjua zeri i Xhinit:

-Rozi!

-C'ke Xhin, pse me kaq nxitim?. Mbushu nje here me fryme. Kushedi c'vra ke bere...i tha Rozi duke e verejtur me kujdes, e nderkohe kafshoi gjuhen, kur vuri re se me te veretete, Xhini kishte bere vrap.

-C'ka ndodhur?

-Eh ta dish, se kush eshte poshte do flisje ndryshe...

-He pra thuaje te shkreten!

-Eshte ai dreq avokati i milionerit Van Deli, po vjen ketu...

-Mos!..thrriti Rozi sikur ndonje shperthim te kishte ndodhur neshpirtin e saj, e me ze qe i dridhej vazhdoi:

-Therrit profesorin!. Mos ke ndermend qe une te behem preh e pyetjeve te tij. Nuk mundem me te vertete nuk..

Rozi e shkrete nuk mund ta perballonte merzine. Lotet desh rrodhen si rreke por ajo u permbajte me te shpejte per te mos e vene re kolegu i saj. Ajo e kishte zakon gjithnje, qe momentet e hidhura t'i kalonte ne zyre te saj, perballe atij peisazhi natyror te pikturuar. Edhe kesaj radhe ashtu ndodhi me te. Xhini si gjithnje e ndoqi me sy. Sa inat i vinte qe gjithnje ai duhej te behej shkak qe Rozi te merzitej. Veshtrimi i tij ate moment u perqendrua tek femija sikur dontet'i thoshte lamtumire. Po nuk priti me, por me te shpejte u largua per te lajmeruar profesorin. Duke nxituar, ai mendonte se ishte shume i lumtur qe nuk ishte ne pozitat e profesorit, keshtu qe ai vete ishte i cliruar nga pergjegjesite e larta.

-Me falni, zoti profesor!..tha me ze te ulet Xhini kur pa qe profesori po lexonte nje artikull shkencor.

Profesori ktheu koken me sy qortues sikur donte t'i thoshte: "Nuk e sheh qe jam i zene?"

-Profesor kemi vizita . vazhdoi Xhini

Profesori ktheu koken . la revisten afer nje mbeshteteseje e duke e perkulur paksa koken ne shenje pyetese tha me buzën ne gaz:

-Mirese te na vijne . Por me cilin kam nderin te takohem Xhin?

Syte e Xhinit e shikonin ne qetesi profesorin sikur deshën t'i thoshin. "A je ne gjendje profesor t'a mbash tani kete buzeqeshje?"

-Avokati i milionerit Van Deli. . tha prere Xhini.

Profesori menjehere emblodhi veten . Ngriti papritur supet, a thua se ndonje dha urdher "Gati tu!"

Zgjati duart , tregulloi floket dhe ktheu shikimin nga dera.

Ne shkalle undiene hapate lehte e te ngadalte . Dukej qarte qe ishte nje ti i qete ai avokat . Ne dëre trokiten dhe hyri brenda nje njeri i vogel , imcak me nje kostum te zi . Xhini e pa dhe per nje cast i erdhi te qeshte . Aq i vogel ishte sa koka e tij , arrinte tek supet e Xhinit . Se dyti e ecura e tij burrerore nuk shkonte aspak me ate pamje dhe se treti , ai shikim finok dic i kujtonte Xhinit . Avokati u afrua , afer profesorit pas prezantimit . ndersa Xhinit i hodhi nje veshtrim te terthorte . Dukej qe atij nuk i interesonte te bisedonte me doktore te

rinj. Kjo gje i pelqeu Xhinit, prandaJ nuk priti shume dhe u largua per tek femija, i cili e priti me buzen ne gaz. Femija edhe atij i kishte hyre ne zemer, natyrisht kishte nje kohe te gjate qe rrinte ne spital. Atij i vinte plasja kur mendonte se pikerisht ai avokat imcak do te merrte persiper ate femije te veshtire. Bah!. Kjo ishte dicka e padurueshme.

-C'fare thate?...pyeti femija ne frengjisht.

-Asgje!

Rozi kushedi c'bente atje ne zyre. Xhinit i erdhi keq dhe u nis per ne zyren e saj. Ishte me se i sigurte se ajo ndodhej ne zyre.

Avokati iu afrua profesorit:

-Besoje se me njihni!. Njehere jemi takuar. A ju kujtohet?

-Po natyrisht..pohoi me koke profesori.

-Prandaj kjo ishte arsyeja qe iu drejtova. Mbase edhe shkaku e kesaj vizite e dini.. i tha ai njeri i vogel profesorit duke e shikuar ne bisht te syrit. Kete metode ai e praktikonte shume

-Te jem i sinqerte, shkaku nuk e di!

-Ju keni ketu nje femije te aksidentuar rende.

Profesori u vrenjt. Nxitoi t'i pergjigjej pyetjes:

-Po!

Desheroj qe te di per shendetin e tij. Si eshte tani?

-Mjaft mire, pothuajse eshte sheruar.

Ate moment avokati mori pamje serioze, nxori nje bllok, shfletoi dhe shenoi dicka ne te. E mbasi e beri kete pune, iu drejtua profesorit me nje ton, i cili nuk i shkonte aspak per shtat atij trupi imcak:

-Atehere mendoje se femija mund te largohet nga spitali!

Fytyra e profesorit u ngrys. Ai nuk duronte, qe vendimet te merreshin pa lejen e tij. I skuqur flake ai pyeti:

-Po c'lidhje ka femija me ju avokat?

Avokati qeshi. Ajo e qeshur ia ngritui nervat akoma me shume profesorit, i cili mezi po e permbante veten.

Avokati i zgjati dokumentat per terheqjen e femijes nga spitali.

-Ju nuk e dini arsyen pse kerkoj terheqjen e femijes nga spitali?

-Dua ta di!...foli profesori me nje ton te ngritur dhe vazhdoi:

-Dua te di se kush jane prinderit e femijes?. Besoj se kaq te drejte e kam, pas gjithë asaj qe ndodhi me te dhe qe beme per te?

Kjo pyetje e tronditi pak avokatin, por me tonin e zakonshem ai vazhdoi te pergjigjej:

-Po te kishte pasur prinder ata duhej te ishin interesuar me kohe. Ka kaluar gjithë ajo kohe. Pronari im u vra

ne ate aksident te mallkuar. Ai ishte nje njeri i sprovuar , i zgjuar qe nuk ja hante qeni shkopin. Ky femije per te ishte nga personat me te afert te tij dhe trashegimtari i tij.

Profesori nisi te mendohej, sepse me nje njeri te tille nuk haheshe dot. Po ate cast nje ide e frikshme i lindi:

-Zoti avokat, Van Deliu eshte i jati i femijes?

Avokati e pa profesorin me nje shikim therrespor nuk ktheu pergjigje. I theu kurrizin mbasi i dha doren e nisi te zbriste shkallet duke thene:

-Mos harroni te henen, ne daten 28. Pergatiteni!"

Profesori ishte teper i turbulluar. Pyetjes me te rendesishme ai nuk iu pergjigj. Por nje gje ishte i sigurte se avokati ate pyetje beri sikur nuk e degjoi. Nisi te ecte ngadale. Desheronte qe ate moment ndonje kolet t'i dilte perpara. Dhe kjo deshire pas pak iu plotesua. Madje u takua me dy koleget me te njohur. Xhini e Rozi sapo kishin dale. Rozi ende i kishte syte e skuqur. Ndersa Xhini po e shoqeronte jo vetem ne te ecur por edhe ne bisede.

-Profesor c'tha avokati?...pyeti me nje fryme dhe teper e tensionuar Rozi.

Profesori e veshtrai me keqardhje syte e tyre kureshtare, e mbi te gjitha syte e skuqur te Rozit, te cilet ishin mbushur me frike.

-Ne daten 28, pra te henen femija do te largohet nga

spitali!.. dhe u largua duke turfulluar nga inati.

Ne cdo hap qe bente i shfaqej fytyra perbuzese e avokatit.

-Oh Xhin, c'fatkeqesi!..tha tere keqardhje Rozi.

Xhini po ate moment ngriti doren e ura lehte supeve telarta te Rozit. Nga njera ane i vinte keq per femijen, nga ana tjeter nuk kuptonte pse kjo duhet te quhej fatkeqesi.

Data 28 ishte te pasnesermen. Ngelnin vetem dy dite. Rozi ate moment mblodhi floket e leshuara dhe u drejtua si zakonisht tek femija, i cili e priti me buzen ne gaz. Shikimi i cilter i femijes e plagoste me shume shpirtin e Rozit. Ajo bente cdo gje per ate femije. Si do te duronte ajo kur femija te largohej. Ai femije asaj i sillte lumturi.

Kot nuk thone qe kur desheron qe koha te zgjatet ajo shkurtohet si per inat. Ashtu ndodhi edhe ato dy dite, kur femija do te largohej. Rozi nuk ishte e merzitur, por ne nje gjendje ankthi. Moti ndryshoi. Dielli u terhoq nga fusha e betejes dhe ne vend te tij u futen rete e zeza. Shiu nisi te binte me vertik per dy dite rresht. Sa shume ngjanin lotet e Rozi me ato pika te vogla shiu. Femija e kishte marre vesh qe do largohej dhe ishte merzitur shume. Do largohej nga profesori, i cili ndonese nuk i pelqente ne fillim, ishte nje njeri

injast i mire. Do te largohej nga Xhini shakaxhi, i cili gjithnje e bente per te qeshur. Po atje ku do te shkonte, kush do ta bente per te qeshur ate?. E mbi te gjitha ai djalosh merzitej se mund te largohej nga Rozi. Njeriu me i dashur qe e ndihmoi ne momentet me te veshtira. Por ai e kishte vendosur. Pa te nuk ikte.

Avokati te henen erdhi ne oren 10 te mengjesit. Ate e priti Rozi. Avokati dhe asaj nuk i hyri shume ne sy. Kjo gje beri qe ajo te merrte kuraje. Biseda midis Rozit e avokatit u be e gjate. Por ja qe fatkeqesisht Rozi e humbi davane. Asnjeri nuk mund te dilte kunder ligjit. Per femijen tani hapej nje rruge e re me plot perspektiva, (ashtu thoshte avokati). Ai ishte i vendosur.

Femija e shihte tere frike, ate avokat te veshur me nje kostum te zi, e shihte edhe me vemendje ate fytyre te panjohur me pare. Perkundrazi avokati e njohu femijen dhe e pa me buzen ne gaz. Kur po zbrisnin shkallet e pafundme femija e krahasonte ate me rene e zeze te endrresse tij. Femija ecte ngadale, e pranetij ecte edhe Rozi me syte e mbushur me lot. Femijen e shoqeruan deri ne fund te shkalleve Rozi, profesori e Xhini. Ata hiqeshin sikur nuk kishte ndodhur asgje, me perjashtim te Rozit.

Kur erdhi momenti i fundit, kur femija me ato dockat

te ngrohta i perqafoi duke qare ata nuk e permbajten vehten. Rozie perqafoi femijen dhe nuk po e leshonte duke i thene e perlotur:..."Mos me harro, bukurosh"(keshtu e therrisin te tere ne spital ate). Femija qante dhe i premtonte Rozit se do te kthehej ndonje dite. Pas pak u fut ne makinen e madhe me avokatin dhe u largua.

Makinen e ndoqen te tere me sy, gjersa ajo humbi ne ate rrebesh shiu, i cili ende nuk kishte pushuar. Ata ndoqen me sy edhe ate dore te vogel qe i pershendeste. Por shume paciente i prisnin keshtu qe u futen brenda per te vazhduar punen. Ndersa Rozi u drejtua per nga xhaxhai i saj Mishel Fleiger, njeriu me i afert qe ekzistonte per te.. Mezi i mbante lotet. Fati i saj nga njera ane, qe e kishte dite pushimi dhe fatkeqesia qe shiu e beri qull. Sa hyri xhaxha Misheli e vuri prane zjarrit.

Zakonisht ne dimer moti behej i zymte; qielli mbushej me re te zeza duke vjellur here pas here vrerin stinor. Askush nuk e desheronte ate zymtesi, qe vetem merzi te dhuronte. Mbi te gjitha Rozi e cila ishte plagosuer per te dyten here. Femija nuk kishte dy dite qe ishte larguar dhe ky mot zemerak nuk desheronte qe t'ja lehtesonte vuajtjet.

Ne cdo ce te qytetit mbizoteronte ngjyra gri. Puna vazhdonte me ritmet e zakonshme, por me ngadale e pa deshire. Trotuaret ishin lehtesuar nga pesha e qindra njerezve. Ata tani kendonin ne sinfonine dimerore. Rozi e ulur ne dritare shihte me inat shiun, qe binte. Dukej tamam si nje kercenim pamja e saj. Floket i kishte te shpupuritura, syte e skuqur e gjysem te mbyllur. Mezi merrte fryme me nje shami te madhe ne hunde. Here pas here nen ate shami degjohej ndonje teshtim.

Ishte ora 10 e mengjesit, kur nje zile e permendi nga zymtesia. U ngrit, filloi te rregullonte floket, me te shpejte, pastaj fryu hundet ne menyre qe te mos detyrohej perpara misafirrit t'i fshinte prape, rregulloi fustarin dhe shkoi tek dera

Perpara u shfaq fytyra e njohur e Xhinit buzagaz. As qe i vente mendja me per femijen. Humori i ishte kthyer perseri, ndonese ai mot dimeror nuk kombinohej me pamjen e tij. Xhini i hodhi nje veshtrim nga koka deri tek kembet Rozit dhe nderkohe pa qiellin.

Sec kishte dicka te ngjashme ndermjet Rozit e qiellit.

-Pse nuk erdhe sot?...pyeti ai pa ja hequr syte.
-Kam qene pa qejf..iu pergjigj ajo duke e pare me bisht te syrit dhe nderkohe tha me vete: "Prit kur t'ja kepusi ndonje mufke tani. Nejtase ai beri shume mire qe erdhi sepse do te ma thyej kete zymtesia".

-Kolegja ime qenka semure!

-Perse erdhe Xhin?

-Perte bere nje cike shoqeri. I propozova edhe profesorit por ai nuk desheronte. Une nuk desheroje te flas me persona shume serioze.

Ate moment Rozi qeshi dhe mendoi se dhe ajo ishte ato caste nje person serioz.

-Mjaft me. Mos me rri me ate pamje sikur do te me vrasesh. Jam i bindur se do tesherohesh shpejt si puna ime. - Natyrisht, se ti ma ngjite.. ia keputi Rozi duke e veshtruar me ate menyren e saj.

Xhini si nje person qe e mbante veten, nuk foli. Ishte xhentil dhe nuk desheronte t'a fyente aspak Rozin, ndonese ajo ne nje fare menyre ishte tallur me te.

-Rozi pse rri e merzitur?

-Nuk te duket gje e madhe ty qe u largua femija. Pse pyet kot Xhin?

-Por ai iku e ti ke jeten tende sic ka ai te tijen. E di me se miri qe ju te dy duheshit shume dhe qe ai femije t'a kishte shume nevojen ty. Por ja qe ai u largua.

-Per mua jof...nuk mundem, a e kupton, qe nuk e harroje dot... i tha ajo me nje pamje serioze

Xhini pohoi me koke.

- Ti je e re Rozi. E kaq e bukur!(kete fjale, a kompliment e tha me ze te ulet). C'te duhet ty nje femije pa njeri ne spital?

-Do t'a rrisja une a s'e kupton. Jam aq e zonja!

-Jene vete!...therriti pa deshiren e tij Xhini..C'te duhet ty te adoptosh nje femije kur.....

-Kjo eshte puna ime Xhin!. Por ja qe deshira nuk mu plotesua, Pse flasim kot.

-Por c'te shtyn?

Rozi e pa Xhinin ate moment dhe syte ju veshen me lot. U drejtua per nga nje raft dhe nxorri nje fotografi te nje burri te gjate e te shendoshe, mjaft simpatik. Ja zgjati Xhinit.

Nje dritherime, e lehte e pershkoi trupin e Xhinit kur mendoj:

"Mos valle ky eshte dashnori i saj..jo..jo s'mund..mbase edhe te kete"

-Kush eshte ky?..pyeti me padurim Xhini

-Burri im!

-Burri yt!. Po kur jeni martuar?. Nuk me ke thene ndonje here. foli i deshperuar, ai.

Ajo e pa me seriozitetin e zakonshem dhe me qetesi. Nisi te fliste ngadale perpara Xhinit te shtangur.

-Ka qene para dy vjetesh. Tashti nuk eshte me. Ka vdekur.

Kjo e papritur nga njera ane e tronditi se tepermi dhe nga ana tjeter e cuditi.

- Me vjen keq. Pse s'me ke thene me perpara Rozi?

Ajo prape e pa me ate menyren e saj.

-E cdo te ndryshonte Xhin? Cdo te ndryshonte?
E duke thene keshtu dy lote i rreshqiten. -Duheshim
shume. tha ajo me gjyserm zeri, nderkohe kur po ulej
qe te mblidhte veten.

Xhini ishte aq i zgjuar qe te kuptonte se prania e tij
ato momente e bezdiste kolegen e tij. Hodhi veshtrimin
nga dritarja dhe vuri re se nje mjergulle kishte pushtuar
cdo gje Pastaj u pershendet dhe me nje hap te shpejte
u drejtua per nga ashensori.

Femija i shoqeruar nga nje njeri i panjohur filloi te ecte
ne rruge te panjohura per te. Rreth e rrotull shikonte
pallate te larta te cilat i Dukej se i shikonte per here
te pare. Sapo kishte zbritur nga makina, kishte mbyllur
syte dhe kishte therritur me nje ze mjaft te larte nga
frika se tere ato godina te larta do te binin mbi te. Per
5 minuta rresht syte e tij qendruan te mbyllur dhe dora
e shtrengua pas dores se atij personi te panjohur, te
veshur me te zeza.

Kur hapi syte u gjend perballe nje godine te larte
shume te bukur. Dora e madhe e avokatit e terhoqi fort,
duke e urdheruar te futej brenda. Femija u fut pa
deshiren e tij. Arriten pas pak ne nje salle te madhe,
ku ne krye te saj ishte nje tavoline dhe karrike. Nje e
madhe dhe nje e vogel. Sic duket femijen po e prisnin.

Uulen te dy. Prezenca e avokatit e frikesonte femijen. Mbase ishte veshja e tij, e cila i krijonte frike. Kete gje as ai vete nuk e kuptonte. Ajo rregullesi sikur nuk po i pelqente. Desheronte me mire zyren e Xhinit, qe pothuajse gjithnje ishte e cregullte. Aty mund te beje c' te doje, kurse ne kete salle te madhe vetem te ndrydhte ankthi.

Syte e femijes shikuan me dyshim fytyren e avokatit, qe kishte nisur te shfletonte nje grumbull te madh letrash te sistemuara me kujdes. Edhe kjo femijes nuk i pelqeu. Kjo heshtje misterioze vazhdoi per nje kohe. Papritur kur femija i kishte kthyer krahet ai ngriti koken:

- Ja keshtu, Deni!

Ate moment fytyra e femijes ngriu. Ah ai emer qe aq shume e mundonte. Tani i kujtohej. Quhej Deni . Deni. Deni vetem kaq. Me tutje asgje. Syte e tij shkelqyen. Me ne fund nuk ishte nje femije pa emer. Po ate moment Deni si me frike veshtrori avokatin qe po qeshte. Pse valle e bente kete gje ai?. Dhe nga e dinte emrin e tij?.

Avokati pasi mbaroi se shikuari dokumentat vendosi me ne fund qe t'i kushtohej femijes. Dora e tij u zgjat dhe kerkoi te perkedhelte floket e femijes, por nuk mundi ngaqe femija levizi koken me te shpejte. Syte e tij po ate moment u perloten dhe goja e tij u ha per

te thene dicka:

-Kur do te vije Rozi?

Avokatit nuk i pelqeu aspak, qe femija insistonte me ngulm qe te vinte Rozi. Per avokatin ajo ishte nje doktoreshe e zakonshme pa ndonje rendesi. Atij i hynte ne sy vetem paraja. Syte e asaj fytyre imcake u nxin si ngjyra e xhaketes aq shume sa femija u struk ne vetvete. Me te vertete ai njeri e frikesonte.

- E keshtu! , tani Deni do te kujdesem une per ty.. vazhdoi avokati.

Ndonese Deni i vogel nuk i kuptoi te tera fjalet ne pergjithesi, thelbin e mori vesh. Por heshti. Ishte i merzitur por edhe i tmerruar nga fakti qe do ta ndiqte me pas. Mendimet e tij u nderprene nga zeri i mprehte i avokatit:

-Ne fund te ketij muaji pas afro 6 a 9 ditesh do te te dergojme ne nje koleg shume te njohur. Tamam per bij pasanikesh. Shpresoje se atje do te kenaqesh.

-Dua Rozin!...tha prape Deni.

-Jo kete gjes'ta lejoj. Ti do te shkosh atje ku eshte per te miren tende. Kur te rritesh do ta kuptosh rendesine e shkolles.

Lotet e njome lagen fytyren e femijes, i cili nuk po kuptonte asgje. Nje ankth i madh e pushtonte te terin. Deshte te ikte por rrugen nuk e dinte per te shkuar tek Rozi. Keshtu atij nuk i mbetej gje tjeter vetem te

priste...te priste.

Elane ne nje vaske te madhe aq te madhe sa atiji vinte te bente not ne te. E m̄basi i bene banje, i veshen nje pale rroba te cilat kundermonin era parfum. Pas disa oresh hengri darke, qe nuk e kishte ngrene ndonje here.

PJESA E
DYTE

DISA VJET
ME VONE

- Zoteri desheroni gje tjeter?...foli nje sherbetor

- Faleminderit, asgje. Mund te ikni... u degjua nje ze djaloshar.

Ishte Deni , bukuroshi i spitalit. Veshja e tij elegante kishte nje ngjyre gri. Ishte nje kostum i cilesise se pare. Floket i kish te shtrira ne kufirin maksimal dhe pamja e tij kishte nje hije fisnike. Duhej te ishte afro te tetembedhjetave..

Ai djalosh ne fillim e kishte pasur shume te veshtire te jetonte ne ate kolegji aq te eger. Edhe atje ishte i rrethuar nga femije pasanikesh. Te tere ishin ambicioz te krekosur dhe te llastuar. I ndodhur ne fillim ne mes tyre ai s' dinte si te vepronte. S' dinte si te sillej. Ishte shume i hutuar. Pas nje fare kohe sikur u ambientua. Zuri edhe nje shok te ngushte, qe i ngjasonte paksa atij ne karakter. Edhe me rregullat e egra te shkolles u ambientua, madje shume shpejt. Kete gje e vune e edhe mesuesit e shkolles. Nje dite e vune ne prove dhe ai nuk i zhgenjeu. Ishte me te vertete nje femije teper inteligjent. Ne ate shkolle ai do te pergatitej per t' u bere nje afarist i shkelqyer. Se shpejti nje pasuri e madhe do t' i binte ne dore. Se shpejti i kishin thene. Por se shpejti i thencin. Mbas 8 vjetesh. Si do te duronte ai pa takuar Rozin per te cilen e kishte marre malli. Mbas nje viti shkolle ata kishin te drejte te kryenin pushimet e veres..

Pikerisht tek keto pushime atij i lindi nje shprese.

Sikur gjate asaj kohe ai te rrinte ne shtepine e Rozit!
Me te vertete nje ide gjeniale. Avokati i tij ne fillim nuk
pranoi pastaj u bind.

Po kete kohe c'behej me Rozi? Ajo teper e lodhur (nje lodhje shpirtore), kishte lene punen dhe jetonte ne shtepi. Ishte vere, fillimi i saj, kur nje dore trokiti tek apartamenti 24. E shkreta Rozi sa e pa Denin perballë iu moren mendte. E puti dhe pa pertuar nisi t'a pyeste c'kishte bere tere kesaj kohe. Dhe Deni pa pertuar i pergjigjej me buzën ne gaz. Rozi menjehere e vuri re ndryshimin ne sjelljen e Denit. Ishte bere me te vertete nje femije teper i sjellshem. Tere ato dite qe ndejti tek Rozi ai u kenaq shume. Cdo vit ai shkonte tek Rozi. Xhini, profesori, Danieli sa here, qe e merrnin vesh per ardhjen e Denit gezoheshin dhe e takonin me mall. Kurse persa i perket Xhinit, Deni sa here shikonte fytyren e tij buzeqeshte.

Rozi ishte larguar nga puna keto vjet. Nga njera ane per qetesine e saj dhe nga ana tjetere per te keqen e Xhinit, sepse tani atij i vinte ndrojtje t'i shprehte ndjenjat e tij per te. Por pas nje fare kohe edhe ai u mesua me kete ndryshim ne rrjedhen e ngjarjeve, kur e mori vesh se Rozi e konsideronte vetem si koleg.

Rozi numeronte ditet qe kalonin, per te ardhur pushimet verore. Mezi i priste. Edhe Deni dhe vazhdimisht ne kolegji per ato enderronte. Shoket e kishin inat, qe ai femije ua kalonte.

Ishte viti 1990 kur Deni mbushi 19 vjec. Ate moment ai ndodhej ne dhomen e studimit. Afer kishte edhe avokatin. Avokati ate moment iu afrua dhe dicka i peshperiti ne vesh Denit. Deni teper serioz e ndoqi me sy deri jashte dhe peseri ra ne mendime. Kishte gjithë ato kohe qe vriste mendjen se si kishte qene e kaluara e prinderve te tij. Ky mister e mundonte shume Denin. Nje here kishte pyetur edhe avokatin e tij, por ai i kishte bere bisht bisedes. Kishte provuar edhe here te tjera por prape asgje. Kishte pyetur edhe Rozin, por edhe ajo kishte ngritur supet. Dicka fshihej ketu, ose dicka fshihnin ata.

Ishte errur dhe qepallat po i rendonin. Pas pak fjete dhe ne enderr pa perseri nje burre maje nje shkambi qe e therriste:

-Bir!..bir!..bir!. Dhe pastaj si engjell fluturonte dhe zhdukej ne hapesiren e pafund.

Po e njejta enderr si dikur. U ngrit dhe filloi te merrte fryme me veshtiresi. Ajo enderr qe dikur ishte e bukur tashti ishte kthyer ne nje mundim. Ajo fytyre, aH ajo fytyre e atij burri sa shume i ngjasonte dikujt.

Rozi ate vit ishte vetem, xhaxhai i saj, Misheli, kishte vendosur qe ate vit te jetonte me Rozin. Ky vendim ishte ne te mire te te dy paleve. Misheli beqar dhe Rozi e vetme. Mendoj se te dy desheronin t'a thyenin vetmine. Mendimi ne fakt i lindi Mishelit, pikerisht ne momentin kur po u servirte nje cifti te ri ne klubin e tij. Kjo ndodhi para nje dite. Sa mbaroi orari i punes, Misheli u drejtua nga shtepia e Rozit, ngadale me koken larte, a thua valle sikur te kishte dale nga beteja fitimtar. Ai kishte parashikuar qe ajo re e zeze dhe ai shi i rrembyer do t'ia mbathnin, menjehere sa te agonte. Ah!, vetem se ishte nje person i permbajtur, se do t'ia niste fishkellimes per shtate pale qejfe, apo nuk do t'i shkonte me shendetin e tij te persosur.

Rruga per tek Rozi ishte jo fort e gjate. Rozi ate dite ishte zgjuar heret. Mbasi ishte pastruar shpejt e shpejt, ishte ulur dhe po lexonte nje liber qe ai ia kishte dhene nje mikesha e saj. Ne fakt ajo kishte menduar te rrinte per nje kohe te shkurter me librin por ja qe ajo fluturoi. Leximin papritur e nderpreu, zilja qe ra. Shpejt e shpejt rregulloi floket e gjata e te drejta, ngriti fustanin e kuq qe i rrinte per mrekulli e pasi u be gati, hapi deren me te shpejte.

-Pa shih! pa shih! si na qenke bere!..tha Misheli dhe

me te shpejte u fut brenda. Po t'a shihje ne pamje te pare Dukej teper mosperfilles dhe i zemeruar por ne te vertete nuk ishte ashtu. Rozi po e shihte me qetesi xhaxhan e saj dhe paksa e hutuar. Natyrisht kjo nuk vazhdoi gjate aspak. Ajo u ul prane tij.

- Si je xhaxha mire me shendet?...pyeti seriozisht ajo.

-Edhe pyet me gjithë kete shendet?. Si te mos jem mire. Edhe ti nuk je keq!..foli Misheli

Rozi e shoqëtoi me nje nenqeshje te lehte fare te lehte.

-Rozi! c'ben ne shtepi tere kohen, nuk merzitesh?

-Edhe ka raste, por ti e di qe mua me vjen Deni. Edhe kete vit, e pres, do te vij.

-Po perse erdhe xhaxha?...tha Rozi per te nderruar temen e muhabetit.

-Mendoj se dua t'i ze vendin atij Denit tend!

Rozi ate moment ngeli si e hutuar dhe papritur filloi t'i flase:

-Oh xhaxha sa deshire kam, sa deshire!..dhe iu hodh ne qafe tamam si femijte e vegjel.

-Jo, keshtu de!. Nuk jee vogel te besh si kalamajte..tha ai duke e zene prej supesh.

Ka raste qe te papriturat mund te ndodhin ne nje dite.

Ata ishin ende te mallengjyer, kur zilja ra per te dyten here.

Rozi u hodh perpjete dhe u be gati te hapte deren.

Misheli e shikoi ne qetesi, kur degjoi:

-Deni, Deni! Si je mire?. C'thote shkolla?

Deni hyri brenda. -Te prezantoj me xhaxhane tim, Mishel.

Misheli buzeqeshi. Biseda ne fillim filloi ngadale pastaj filloi te shpejtohej. Rozit, i pelqente kjo atmosfere kurse Denit aspak. Prania e xhaxhait nuk e lejonte te kryente ate detyre qe i kishte vene vehtes, ende ishte i turbulluar nga endrra qe kishte pare ate nate. Edhe vete i vinte cudi se si kishte mundesi qe te mendohej...dhe per cfare, thjesht per nje enderr. Here e pranonte kete aresyetim, here jo, por me rendesishmja per te ishte se si t'i fliste vetem per vetem Rozit. Misheli per te ishte nje burre teper dashamires por per ate moment i tepert per te. Biseda vazhdonte e bashke me te edhe koha ikte.

Nisi te errej. Misheli si me i moshuar kishte nevojte c'lodhej. Mbi shpatullat e tij rendonte lodhja e dites. Kjo peshe iu trasmetua edhe syve, te cilet nuk rezistuan dot me. Ne dhomen tjeter ngelen tashti vetem Rozi me Denin. Ai ktheu koken nga Rozi. I vinte zor mos e qeshte, e tallte per ate pyetje qe desheronte ai t'i bente.

- Rozi, dua te te them dicka!

Menjehere Rozi la punen dhe u ul prane tij. Dhe me syte e saj te kalter qe u perqendruan, ajo i dha kurajo t'i fliste. ne fillim me ze te dridhur pastaj me fort ai mundi t'i peshkruante tere ato qe mendonte.

Rozi e degjoi ate enderr edhe mendimin e Denit. Ra ne mendime. E kishte shume te veshtire t'i sqaronte te verteten, te cilen ai e kishte kerkuar. Si t'i thoshte qe nena i kishte vdekur bashke me te jatin.

-Den i dashur, te lutem kete gje mos ma kerko. Mos me mundo!

-E perse?. Une dua te di te verteten!

E rrethuar nga stresi dhe kembengulja e Denit, ajo arriti t'i thoshte te verteten e hidhur. U ngrit per te shikuar reagimin e Denit. Por per cudi hic. Si kishte mundesi?

-E di Rozi kete e di., dhe duke e shikuar seriozisht e pyeti:

-Tani dua te di perse Viktori flet ndryshe?

-Cili Viktor? (ajo ishte pushtuar e tera nga ankthi), sepse e dinte qe kishte te bente me nje femije jo do si do. Por prape nuk e kuptonte. Ajo i kishte thene te verteten. Kur ja papritur nje mendim i frikshem i lindi ne koke. Mos valle ajo e vertete qe e dinte nuk ishte e sakte. Po cila duhej te ishte valle?

-Pra keshtu baba im eshte milioner. Viktori eshte nje miku im i beses, i cili me tha se babai im ka qene beqar..foli si me tallje ai.

Toni i tij ate moment u kthye ne nje ton lutes.

-Megjithate kete nuk e di me siguri.. Dua te kujtoj te kaluaren por nuk mundem. C'fare duhet te ketene ate

mendjen time.

-Mos valle? ..tha si me frike Rozi

-Cfare the?

-Nejse. Persa i perket asaj endrres te keshilloje te mos e vrasesh shume. Eshte thjesht nje enderr e asgje tjeter;

-A e kupton qe ate person e njoh, e njoh shume Rozi. Eshte nje person nga e kaluara ime. Ah sikur ta shihja ne realitet. Ai me zgjon nje shprese. Cili mund te jete valle?

Per nje kohe ra nje qetesi e cila u bashkua me ate te nates. Asnjeri nuk, shkonte te flinte dhe asnjeri nuk levizte. Here pas here veshtrimet e tyre takoheshin por prape largoheshin. U gjjet nje shkak per t' a thyer kete heshtje: Nga dhoma tjeter Misheli ia kishte keputur gjumit me nje gerhim fort te bukur e tingelluese. Rozi buzeqeshte kurse Deni aspak. Ai ngriti koken me seriozitet dhe duke shikuar me vemendje fytyren e Rozit, e pyeti:

-Me sqaro, milioneri, "babai im", eshte francez.

-Po..ate moment zeri i saj doli si e kercitur e deres.

-A jemi ketu ne France?

Kesaj pyetjeje ajo iu pergjigj me nje veshtrim te venger sikur donte t' i thoshte:

-C' eshte kjo pyetje Den?

-Rozi nga e di une gjuhen shqipe. Ne spital ate gjuhe kam folur?

Rozi e pa me cudi duke menduar se me te vertete dic fshihej pas kesaj. Po futej ne nje lemsh teper te ngateruar,. Nuk mundet 'i pergjigjej.

-Mos une jam nga Shqiperia perderisa di gjuhen e atij yendi?

Syte e kalter te saj rrinin e veshtronin me cudi dhe me adhurim, duke menduar per ate arsyetim te persosur te tij.

-Ne shkolle me kane thene se eshte nje vend misterioz, i cuditshem, i vogel e i ashper. Sa here qe mernin vesh qe dija gjuhen e ketij vendi cuditeshin duke thene se shume rrallendonje franceze mesonte kete gjuhe...tha prape Deni akoma me i sigurte ne vetvete. Ndersa Rozi ende heshtete duke pritur mbarimin e arsytimit te tij.

Nata ishte pa yje dhe hena e venitur. Cdo gje kishte rene ne gjume. Vetem ata te dy rrinin ende. Gjumi ju kishte ikur. Kur ja papritur, Deni u ngrit sikur te ishte permendur, ferkoi syte, rregulloi kemishen me qetesi duke vazhduar te thoshte me nje ton te forte e fitimtar:

-Pasneser ne Shqiperi!

-Den, je ne vehte!...i shpertheu fjala Rozit.

Ai ktheu koken nga ajo dhe tha:

-E kam vendosur!. Jam apo nuk jam burre. Dhe duke u krekosur u drejtua per nga dhoma e vogel e fjetjes.

Ajo ia dha te qeshures por shpejt kjo ju kthye ne trishtim. Duhej patjeter tashoqeronte ne kete udhetim. U drejtua edhe ajo nga shtrati. Nata e kishte bere punen e saj. Ne koke i rrotullohej vetem ai mendim. Pothuajse vetem per nje gje ishte e qarte. Kujtesa e se kaluares atij i kishte ikur. Dhe me kete mendim e zuri gjumi.

Ishte afro 6 e mengjesit kur Deni u zgjua. Ne te vertete kishte bere nje gjume te lehte. Sa hapi syte perballe i doli fytyra e qeshur e Mishelit. Edhe Rozi nuk kishte shume qe ishte zgjuar. Te dy u drejtuan nga tavolina. Rozi hante ngadale dhe here here hidhte veshtrimin nga Deni, i cili as qe e kishte mendjen. Ajo ato momente po mendonte nese ai e kishte thene me te vertete ate fjale dje. Misheli nuk dinte gje dhe ajo nuk kishte si t'a pyeste ne syte e tij. Por edhe mengjesit i erdhi fundi. Deni teper i qete u ngrit ende me pecete ne duar, fshiu buzet dhe u drejtua per nga telefoni. Gishti i tij i holle shtypi tastieren dhe ja dikush i foli: -Alo, alo! Zoti avokat, ju mora per t'u thene se neseser do te nisem ne Shqiperi... A me lejohet?.... Mire, mire do te vij vete t'ju takoi.

Dhe mbasi tha keshtu e mbylli telefonin. Rozi buzeqeshi, i pelqente teshkonte ne ate vend misterioz.

Cdo gje e re dicka te vecante mbarte ne vetvete.

Gumezhima e rrotave te medha te aeroplaneve ne piste sikur po e bezdiste pak si shume Rozin, e cila ate moment kishte kthyer koken drejt qiellit mbi te cilin nje aeroplan i vogel po fluturonte. Hapat e saj ishin si te paperfillshem ne ate mori zhurmash maramendese. Floket e saj te verdhe ishin shpupuritur nga era e tepert. Dora e saj mundohej here pas here tirregullonte por era e mundonte ne dyluftim. Perballe fytyres se nervozuar te Rozit qendronte e qete e paksa e qeshur fytyra e Denit. Shikimit te Rozit teper misterioy i pergjigjej nje veshtrim teper i vendosur. Ai kishte veshur nje kostum te zi ashtu sic u ka hije zoterinjve. Por te themi te drejten, ky nuk ishte shkaku i kesaj veshjeje. Rozi ia kishte cilesuar se ishte i vetmi kostum qe i shkonte. Persa i perket asaj, ajo ishte e veshur me ate fustanin e kuq. Te dy te veshur mire, po shkonin drejt nje te papriture. - Avioni per Tirane , niset nga porta 10 per 30 minuta, ude-

gjua zeri i spikerit. Pasagjeret te behen gati

-Shkojme!, tha Deni, duke terhequr prej krahu Rozin.

U futen me te shpejte, ne sallen e kontrollit te biletave

, dhe pasi lane bagazhin, u drejtuan per ngas salla e

pritjes.

Pas pak u gjeten te dy brenda ne avion. Aiu ngrit e pasi perqafoi rete u zhduk ne kaltersi. Shikimi i tyre i paduruar drejtohej nga rete qe shtriheshin poshte tyre si pambuk. Mendimet e tyre ishin perqendruar vetem per ate vend misterioz ku po shkonin. Si ishin keta njerez? Mendonte parreshtur Deni. Shume mendime i hypnin ne koke. I dukej se do te shkonte ne vendin e Robinson Kruzos, i dukej se do te takonte njerez ndoshta diva te zymte. Kete ai se dinte.

Perkundrazi Rozit i dukej se do te shkonte ne vendin me te bukur ne bote. Po njerezit? ... Aq shume ishte futur ne mendime sa qe harroi ku ishte dhe tha me ze me vehte:

- Oh zot! C'fare duhet te jete Shqiperia?

Disa te rinj, te pashem qe ndodheshin perpara Rozit, kthyen koken e mbasi e veshtruan mire, fytyren e imte e te skuqur te saj, iu pergjigjen :-Shqiperia, eshte vendi yne.

Pas pak njeri prej shqiptareve, u drejtua dhe me ze te lart tha:

-Jemi shqiptare, e cka ketu per tu habitur!

Ndonese Rozi ishte ende e habitur, vuri re qe nje lot rreshqiti ne faqet e tyre, te njoma nga mosha por te ashpra nga pamja.

Nje burre i shendoshe, qe ndodhej pas Denit, tha me

ze te ulet:

-I kane perzene, te shkretet nga Franca e po i kthejne ne Shqiperi.

Kaq u desh dhe Rozi u ndez:

-Perse duhet ta bejne kete?, edhe ata njerez jane si ne. Burri i shendoshe e pa si me cudi, dhe i beri dredh pyetjes se saj me nje buzeqeshje ironike.

Qetesi e perziere me ate gumrzhimete lehte te fluturimit. Tani ajo nuk mendonte, por vetem shikonte floket e atyre djemeve shqiptare. "Perse i quanin misterioze? Ata ishin te pashem. Perse i quanin te eger?"

Edhe Deni mendonte per te njejtën gje. Fjalet e tyre e kishin prekur. C' duhej te bente? Deshe te therriste se edhe ai ishte shqiptar, por kush do ta besonte? Qe prej atij momenti te dy ata vizitore nuk ishin me te habitur. Kishin bere shume mire qe ishin nisur drejt nje misteri. Shume prej atyre njerezve ishin te huaj. Vetem tre shqiptaret rrinin me sy te ngrire drejt tokes.

C'kerkonin veshtrimet e tyre? Kishte kaluar nje kohe e gjate, dhe Rozin e zuri gjumi, pa dashjen e saj. Cuditerishte, n'ate dite te jashtezakonshme, ajo po flinte shume e qete. Pas nje fare kohe, nje dore e preku lehte, aq sa ajo u hodh perpjete nga e papritura. Nuk mbizoteronte me qetesia e meparshme.

-C' pate Den qe me zgjove?, i u drejtua ajo Denit,

-Arritem, Rozi!. Jemi ne Shqiperi.

Rozi u zgjat për të shikuar dhe vuri re nga lindja vargje malesh të reshtuar njëri pas tjetrit, të veshur me një mjegulle të lehtë, në majat e tyre. Sytë e saj bojeqielli herë shikonin poshtë, herë Denin e perlotur. Përdashur, për një moment, ktheu kokën nga shqiptaret e pashëm që ishin duke biseduar në gjuhën e tyre.

— E po të tere duken sikur i ka bërë një nënë, sa shumë mallëngjehen?—

Aeroplani po bente uljen drejt aeroportit të panjohur. Anash nga lindja, majat e maleve sa vinin e beheshin me të qarta, e dukej sikur aeroplani do të ulej mbi to. Mjegulla filloi të shtohet dhe pamja e atij vendi po veshitesohej. Rozi filloi të hutohet nga padurimi për të parë se çfarë ndodhte përjashta. Por një dridhje e fortë e trupit të aeroplanit e shoqëruar me një fishkellim të mprehtë, tregoi se aeroplani kishte zbritur në aeroport. Përjashta kishte filluar të ngryset, dhe dukej sikur erresira gërshej me mjegullën e lehtë të maleve që sapo kaluan.

Aerporti quhej Rinas. Ishte një aeroport fare i vogël. Pasi zbriten nga shkallet e aeroplanit dhe kaluan rreth njëqind metra në këmbë nëpër aeroport, u ndalën para një dërrë të vogël, ku një tabelë e shkruar në anglisht tregonte doganën. Në doganë iu desh të prishte një kohë goxha të gjatë. Kjo gjë e bezdisi dhe e merziti Rozin. — Le të shpresojmë se me tëj nuk do të ketë

gjera te tilla te merzitshme“, tha me vehte, Rozi. Jashte doganes, i priste nje veture e vjeter. Per nje moment ajo ferkoi syte.

Shoferi i vetures, u doli perpara dhe u uroi mjeresardhjen. U futen ne veture dhe u nisen menjehere. Ishin te lodhur dhe mezi prisnin sa te mberrinin ne Tirane.

Sapo mbriten u futen ne hotel, ku kishin rezervuar dhomat dhe u ngjiten menjehere ne to per te pushuar. Pas pak cdo gjera ne qetsi, dhe me mendimin se kishin mbritur shendosh e mire ne Shqiperi, i zuri gjumi.

Vera, kjo stine e nxehte, e mbushur me gumezhimen e zeravënjerezor, sapo kishte mbaruar. Po vinte vjeshta me freskine dhe melankloline e saj. U zgjuan nga cicerimat e zogjve. U habiten, se si ishte e mundur qe ne nje qytet te madh te kete cicerima zogjesh.

Deni u zgjua i frikesuar nga endera qe i perseritej vazhdimisht. Po i njejt burre perseri... E njihte. Perte kishte ardhur. Fakti qe asgje nga e kaluara nuk i kujtohej, e tmerronte. Ungrit me te shpejt dhe trokiti ne dhomen e Rozit. Ajo doli dhe e futi brenda. Edhe ajo kishte nje ndjenje frike. E perqafoi Denin sikur te kerkonte nje fare mbrojtje tek ai. Po nga kush?

Pasi u veshen zbriten ne hollin e madh te hotelit .
Pasi veshtruan fytyrat e vizitoreve te tjere, qe kishin mbushur hollin, disa ne kembe dhe disa te ulur, duke pire kafe, kerkuan me sy personin qe duhej ti priste. Dukej se asnjeri nuk kishte ardhur per ta. Pa pritur, nje burre afer te 40 u afrua, dhe iu drejtua Rozit duke i propozuar te ulej afer nje tavoline, ne ferngjisht. Veshtrimi i tij ishte gershetim i sinqeritetit, bukurise dhe egersise. Nje mozaike te tille, Rozi nuk e kishte vene re me pare ne asnje fytyre tjeter njerezore.

-Jashte u pret makina, qe do tju coj atje kute desheroni, u tha me politese, burri 40 vjecar. Per cdo nevoje tjeter qe te keni, une jam ne dispozicionin tuaj, mjafton qe te me lini nje njoftim tek pritja.

Pasi u pershendeten, ata dolen. Poshte i priste vetura, me nje shofer shqiptar, qe do tu sherbente si udherrefyes.

Deni rrinte ne pritje te dickaje, ndonse ne pamjen e pare Dukej i merzitur. Ku ishin malet e larta qe kishte pare nga avioni?

Ne vend te tyre, vuri re vetem nje koder te vogel me nje godine te madhe te bardhe, drejt se ciles shkonte nje bulevard i gjere, me pisha anash. Ky ishte vendi i vecante? Shoferi u shpjegoi se hoteli mban emrin e malit, ne lindje te Tiranes. Per ta pare ate duhej te

kalonte ne anen e prapme te hotelit.

Hypen ne makine. E ndienin vehten tashme me te vertete te huaj.

-Ku do te shkojme ?, pyeti shoferi .

-Tek malet e ashpra !, tha Deni.

Menjehere, shoferi u kthye dhe perseriti :

-Zoteri, une nuk po tallem, ju lutem ku desheroni te shkoni?

-Ne alpe, u pergjigj Deni, duke e shikuar ne sy shoferine habitur.

Rozi mbeti e cuditur nga kerkesa e Denit. Ndersa shoferi kishte fituar gjendjen e meparshme te qete, duke kuptuar se ai nuk po bente shaka. Pastaj pyeti:

-Per te shkuar ne alpe, duhet vajtur ose ne Shkoder ose ne Tropoje. Mos doni te shkoni ne Tropoje?.

-Sigurisht edhe atje desheroje te shkoje, tha Deni me seriozitet.

-Zoteri, vec duhet te dini dicka, qe rruga per ne Tropoje eshte shume veshtire dhe do te lodheni.

Rruget tona nuk jane si tuajat.

-Po pejsazhi si eshte?, pyeti me nje fryme Deni.

-I bukur, zoteri, ndoshta i mahnitshem, por rruga zoteri eshte e merzitshme. Me keto rruge ju nuk mesoheni kollaj, kurse une jam mesuar.

Deni po hezitonte, nderkohe qe shoferi ra ne qetes, ne pritje te urdherit per tu nisur .

-Prisni pak, sa te marrim bagazhet tona!, u degjua zeri i Denit, duke dale nga maqina. Rozi e ndoqi djaloshin me ngadale.

Shoferi rrinte dhe mermeriste:

-„C`te hua! te cuditshem!, ne vend qe te rrine rehat ne hotel, desherojne te thyejne zverkun rruge e pa rruge“.

Shikimi i tij u perqendrua ne nje ce te hapsires per nje kohe te gjate. Papritur e permendi zeri i Denit:

-Nisemi!

Deni i kenaqur, iu afrua Rozit dhe i peshperiti:

-Tani do te na jepet mundesia te shohim ato male te larta, qe i pame nga aeroplani,

Ai dicka parandiente.

-Sa te dalim nga Tirana, peisazhi do te ndryshoje menjehere, u tha shoferi.

Per nje moment shoferi ktheu kokën nga dy vizitoret e cuditshem, te cilet me fytyra te rrahura nga era, po kundronin peisazhin qe kalonte para syve te tyre.

Diku, makina kalbdi mbi nje grope dhe vizitoret pesuan nje tronditje te forte. Rozit iu kujtua paralajmerimi i shoferit dhe i ra ballit me dore. Filloi te tundej nga tronditjet e makines.

Veshet e saj teper te mprehte degjuan blegerima dhe perpara saj u duk nje kope delesh. Nje ere e lehte fryu rreth saj dhe si nje ngacmues mendimet serish asaj

zgjoi. I Dukej se ishte kthyer disa vjet pas. Syte e saj qendronin tengrire perballe atij bariu qe ne ngadalesine e veprimeve te tij Dukej si nje luftetar. Vrazhdesia e fytyres se tij, syte e futur thelle ne mes te rrudhave te panumerta, shikimi i tij thike e beri Rozin qe t'a simpatizoi. Asaj nga casti ne cast ai bari do te kthehej ne nje luftetar te se kaluares. Ai person ecte dhe ne pluhurin qe fluturonte nga rrotat e makines. zhDukej dale ngadale si nje hije ne sinfonine e blegirimave te magjishme.

Per nje moment perpara saj u duken malet e bukur e te cuditshem.

Ajo veshtronte Denin. Shikimi i tij ishte drejtuar tek malet.

Deni Dukej sikur kishte rene ne nje heshtje te pafundme. Kur makina tronditej fort ai padashur buzeqeshte. Rozi dic kuptonte. Ndoshta ate te pakuptueshmen, qe rreshqiste ne ate mendje te atij djali. Makina hidhej e shoqeruar me te qeshuren e mistershme te Denit.

- "Perpara drejt veriut" ..Dukej sikur therriste ajo.

Ne nje moment perballe tyre u shfaq nje burim.

-Desheroni te zbrisni, te freskoheni pak, zoterinj...u degjua zeri i shoferit

-Natyrisht..thane ne nje ze Deni dhe Rozi.

Te dy vizitoret u afruan afer burimit per te pire uje.

Nje vajze shqiptare u afrua dhe me nje ene te madhe mbushi uje. Aq deshte Deni kurioz, dhe pa ndrojtje u ul per t'a shikuar me mire fytyren e asaj vajze shqiptare, te veshur me rroba karakteristike". Kjo veshje dicka i kujtonte ne mjergullsine e mendimeve te tij. Vajza ishte shume e bukur. Kjo e beri Denin t'a

shikonte me me verejtje. Por cuditerisht ai ngeli i habitur kur ajo i ktheu kurizin mbasi e pershendeti ftohtesisht, u largua. Me te shpejte si nje femije i ndjeshem ai iu afrua Rozit e si me te qare tha:

-Nuk desha ta fyeja. Se bera me qellim te keq... e si te mos mjaftonte kjo ai iu afrua dhe i peshperiti.

-Megjithate ishte shume e bukur.

Nje grua iu afrua Rozit dhe e pershendeti me shume miresjellje: -Tungjatjeta!

Rozi ia ktheu pershendetjen, por me shume veshtiresi. Iu duk nje fjale engaterruar edhe e veshtire ne te folur.

Paspak ata u drejtuan serisht ne makine. Desheronin te sodisnin akoma me shume. E mbite gjitha kete deshire e kishte Deni. Ne mes te zhurmes se motorit te makines ata enderronin. Parandjenja e Denit sa vinte forcohej akoma me shume. Tymi i shoqeronte kudo dhe here here ate e zevendesonte nje shi i imet qe paralajmeronte ardhjen e vjeshtes. Malet shtoheshin si

lulet ne pranvere e nashke me to sillnin madheshtine e Shqiperise. Makina ecte ne pafundesi e drejtuar nga shoferi qe buzeqeshte.

Deni ktheu koken dhe nisi ta sodiste me adhurim fytyren e qete e te palevizur te Rozit

-Sa e mire qe eshte. E dua si nene.. e mbasi the keshtu vazhdoi:

- Po nena ime e vertete kush eshte.?

Si pergjigje te kesaj pyetjeje ai mori vetem nje feshfetime te lehte prane tij. Syte si zakonisht u drejtuan nga malet qe zevendesonin njeri tjetrin e zhdukeshin si hijet e motshme. Ndersa Deni kerkonte ne keto zhdukje dicka te pakapshme por teper te rendesishme. Kur valle do ta gjente ate?

Nje pjese te kohes Rozi e kaloi ne gjume kurse Deni vetem duke veshtruar ata vigane te lashte, pa vrare shume mendjen per vendet qe kishin kaluar. Makina ecte ne pafundesi duke u dredhur si nje kafshe e terbuar. te dy vizitoret hidheshin te tronditur nga rruga tere gropa e tere kthesa. te dy nuk e kishin fare konceptin e kohes. i kishte zene per nje moment gjumi.

-Edhe nje cike dhe do te arrijme ne Bajram Curri. Aty desheroni te qetesoheni?.

-Kemi shume rruge per ne Tropoje?... tha neper dhembe Deni duke mbajtur stomakun me dore. E ndjente se

nuk do te rezistonte me po te vazhdonte keshtu.

Rozi u zgjua dhe pyeti:

- Sommes arrives?

Nje e qeshur e lehte vijoi ne buzet e Denit .

Pas cerek ore ata arriten.

Nata me pelhuren e saj te zeze kishte mbuluar gjithshka ndoshta dhe fytyrat e te dy vizitoreve qe kishin arritur ne Bajram Curri. Dicka enigmatike i shtynte per te shpresuar . Ata kishin arritur pas nje udhetimi te lodhshem. Qellimi i Denit valle a do te realizohej?. Ai dalengadale hoqi corapet e erreta dhe si nje viktime e pafajshme e gjumit mbylli syte gjysem te venitur. Keshtu nata nuk e la te mendohej.

Kishte ardhur dita e re. Cuditerisht dielli kishte dale me heret e si nje portokall i kuq ndriconte. Denit i shpoi hundet ajri i fresket, teper i fresket; kjo i shkaktoi nje maramendje te re. Kerceu nga shtrati dhe papritur shume therriti Rozin. Ajo teper e corientuar harroi te rregullonte floket. Hapat e tij te shpejte trokellinin, ndersa Rozi mezi merrte fryme nga ai hap i shpejt

“O zot!, c’ po ndodh me kete femije. Pa le me mua qe nuk jam ne gjendje ti kundershroje”. E duke hedhur veshtrimin drejt qiellit ajo vazhdoi :

- Sigurisht ketu ka dicka te mbinatyrshme.

Duke mermeritur lehte ajo ndoqi Denin, qe kohet e fundit ishte bere disi i cuditshem. Perballe tyre u shfaq nje peisazH i ri, me male, mbi te cilet mbizoteronte nje gjelberim i papare ndonjehe-re.

-Mirdita zoteri, zonje. Keto qe po shihni jane malet e mbushura me geshtenja, karakteristike per ketu, ne Bajram Curri.

Kete sqarim Deni e priti me seriozitet.

-Zoterinj, kam nderin tju njoh me nje kusheririn tim ketu, po te

doni mund te vizitoni studion e tij. Eshte teper i apasionuar, u

tha shoferi, duke mbajtur perkrahu nje djale te gjate afer te 30,

me nje shikim dashamires, qe pershendeti menjehere te dy vizitoret e panjohur.

Deni pohoi me koke. Rozi e ndoqi e kenaqur. Ajo e dinte se Deni i kishte qejf pikturat.

Pasi bene nje rruge jo shume te gjate, arriten ne nje shtepi private, teper te cuditshme, qe lulet kacavjerrese, e kishin mbuluar krejtesisht, aq sa catia e saj Dukej e gjelber.

Si pershendetje te pare morren nje te lehur qeni. Te dy vizitoret hyne brenda, ne nje dhome te vogel, te

rrethuar me piktura te shumellojshme. Rifilloi shikimi ne heshtje. Deni Dukej se dicka pelqente n' ato pamje, ndoshta malet. Ne nje moment ai peshperiti:

-C'mrekulli!,

Piktori 30 vjecar e ndoqi ne heshtje, ate vizite, sikur ajo ishte nje detyre per te. Qetesia e vezhgimit, i kishte pushtuar te gjithe. Te huajte shikonin portretet, ndersa shqiptaret te huajte. Kjo qetesi nuk vazhdoi gjate. U prish nga nje britme e lehte e Denit. Rozi menjehere u drejtua nga ai. C'kishte ndodhur?

Valle perse syte e tij ishin ngulur ne nje portret te vogel, valle perse piktori i ri, rrudhi vetullat, sikur te kishte kuptuar dicka te pakapshme. Shikimi i Denit ishte i turbullte.

Deni u ul ne nje karrike, me veshtrimin e ngulur tek nje portret, i vizatuar ne nje pelhure teper te vjeter. Portreti paraqiste nje femije 3 vjecar, me duar te zgjatura, diku larg, dhe me sy te perlotur.

Rozi u afrua prane Denit, dhe u mundua t'ia terhiqte vemendjen nga ai portret. Por kjo ishte e pamundur. Piktori rrinte ende i heshtur, sikur ta kishte kryer detyren e tij. Ndersa shoferi kishte sjelle nje gote me uje per Denin.

Papitur, Deni u ngrit, duke e veshtuar piktorin me nje veshtrim pyetes, e hoqi me ngadale portretin nga muri, dhe e shterngoi forte ne gji.

Rozi nuk po e kuptonte se cfare po ndodhte.

Deni, mermeriti papritur :

- "Une, une, ketu jam une "

Piktori u drodh, dhe duke iu afruar me te shpejte, tha:

- Cfare thate ?, perseriteni dhe njehere ju lutem .

- Ky eshte portreti im, megjithate shumekush nuk ka pe te me besuar. Kush e ka bere kete potret?

Rozi po e veshtronte e habitur po dhe e friksuar. Atij

po i kthehej kujtesa. Po nje gje duhej sqaruar : " Perse ajo piktore ndodhej atje? "

Ajo hodhi veshtimin nga piktori, dhe e pyeti:

- Ju e keni bere kete piktore?,

- Jo, u pergjigj piktori, piktura nuk eshte imja; ate ma ka dhene nje burre.

- Cili u a ka dhene ?, ku ndodhet ?, pyeti Deni me ze te dridhur.

Piktori ktheu koken nga Deni menjehere, e duke e shikuar ne sy e pyeti:

- Me te vertete ju jeni ne kete piktore?,

Deni pohoi me koke.

- Po te desheroni , po ju coj une tek personi qe ma ka dhuar kete piktore; nuk ndodhet shume larg qe ketej, vetem disa ore.

Te kater hipen ne makine dhe u nisen menjehere per tek miku i piktorit, i cili banonte ne luginen e Valbones, mes alpeve.

Denit i dhimbte koka shume, dhe pas saj pati nje marrjemendesh.

Mbylli syte dhe nje morri ngjarjesh filluan ti shfaqen. Rozi i shterngonte doren forte Denit. Pas dy oresh arriten deri tek nje vend, me tutje makina nuk shkonte dot. U duhej te ecnin ne kembe sepse miku i piktorit banonte ne nje qoshe ku nuk kishte rruge.

Vendi rrethohej nga male te larta, te thepisura, diku te erreta, diku ngjyre roze ose te kuqeremta deri ne te kalter. Ndryshonte ndricimi, ndryshonte dhe ngjyra e tyre duke marre gjithë nuancat e ylberit.

Poshteridhte lumi Valbones, zhurma e te cilit Dukej si nje simfoni, midis atij peisazhi magjepes.

Ndejten per nje kohe te palevizur midis kesaj bukurie magjike.

Te dy vizitoret e ndiene vehten te pavlere para asaj bukurie.

Deni eci, dhe nxitoi hapat. Donte qe sa me pare te takonte mikun e piktorit. Piktori ecte perpara. Hapat e tyre beheshin gjithmone e me te sigurte.

Nga lart u duk nje shtepi e vogel alpine. Sa me shume i afroheshin, aq me shume Denit i shtoheshin te rrahurat e pulsit.

Megjithate ai ecte me nxitim drejt saj.

U gjenden para nje dere te vogel prej druri. Rozit i Dukej se po jetonte nje perralle.

Piktori trokiti ne deren e vogel. Nga brenda u degjua zeri i nje burri:

-Dera eshte e hapur, hyni !,

Ne fillim piktori, pastaj shoferi, Rozi dhe ne fund Deni, hyne me kujdes se mos vriteshin tek dera e ulet.

Nje dhome e zakonshme, u shfaq para tyre, e lyer me ngjyre te kalter, me dy mindere me pellush, anash oxhakut, dhe me disa portrete te varura neper mure.

I zoti i shtepise ende nuk po Dukej.

Dicka po pergatiste ne dhomen tjeter. Rozi per nje cast hodhi shikimin nga Deni. Ai i kishte syte paksa te skuqur.

Pas pak i zoti i shtepise, hyri ne dhome. Ishte nje burre rreth te pesedhjetave, paksa i thinjur, me sy te zinje e te shndritshem, me ballin a larte te zbukuruar me disa rudha

Cdo gje tek pamja e tij tregonte per nje jete te veshtire, te kaluar.

-Bujrum!, miresenaerdhet, tha duke iu drejtuar ne fillim piktorit dhe pastaj duke i takuar me rradhe te tjetret.

Kur iu afrua Denit, ndaloi pak dhe duke i zgjatur doren, shikimi i tij u perplas me ate te Denit. Per nje moment mbeten te palevizur qe te dy. Dukeshin te shume te emocionuar.

Per nje moment Rozi vuri re se te dy ata ngjanin me

njeri tjetrin.

Deni desh te thoshte dicka, por nuk arriti, se u rrezua per toke.

Burri krenar e morri nekrahe, dhe duke e veshtruar me butesi, e shtriu mbi nje shtrat te vogel, me sy te perlotur. Pastaj filloi ti perkedhelte floket e tij te verdhe, duke thene:

- Biri im, oh biri im i vogel!

Ata rrinin rrotull tij te heshtur, te menduar. Cdo gje ishte ne pritje te dickaje te mistershme.

Vetem heshtje. Kishte rene nje hije trishtimi mbi syte e atij njeriu te vjeter trupmadh.

Jashte dielli Dukej i madh por nuk bente nxehte. Ata rrinin rrotull Denit pa u preokupuar per motin, me syte e perqendruar mbi ate 18 vjecar te palevizur.

-Kush jeni ju? ... pyeti papritur duke shikuar me vemendje Rozi.

Rozi nuk pati deshire te shpjegohej dhe arriti vetem te thoshte:

-Nje mikeshe e Denit, dhe pasi ferkoi me te shpejte syte u drejtua per nga rubineti.

Ishte nje rubinet i vogel nga i cili uji rridhte vrullshem. I u afrua me hapa te lehte Denit, me syte qe i shndrisnin si rreze dielli dhe nisi t'i ferkoi fytyren me nje nap te

lagur.

Dhe sikur bota te ndryshonte, dhe sikur yjet te rrezoheshin, dhe sikur jeta e njeriut te behej e perjetshme, habia nuk do te ishte me e madhe se para asaj skene. Keni pare dhembshuri te pafundme qe boten e pershkron duke renqethur cdo gje jetesore? Sigurisht qe jo. Ju jeni mikroqenie perpara kesaj dhembshurie.

Shikimi i Denit u puq me ate te te jatit, duarte e tyre u bashkuan, trupat e tyre u perqafuan. Secili kerkonte mbeshtetje tek tjetri. Kerkonte ate ngrohtesi qe nuk ia kishin dhuruar vitet dhe qe ua jepte momenti. Nje padrejtesi tjeter ne kete bote. Dy qenie, viktima te se papritures. Dy qenia pafundesisht te permalluara.

-Biri im ! ... perseriteshin fjalet nga goja e babait te Denit.

Ato dilnin nga thellesia e shpirtit te plagosur si nje shperthim.

Ishte gumbulluar nje dhimbje e madhe per vite me rradhe.

-O zot!, faleminderit per mrekuilline qe me solle, peshperiti me ne fund ai, duke ngritur duart nga qielli, duke veshtuar larte per nje fare kohe. Brenda atyre pak casteve i kaloi fluturimthi gjithe jeta e tij.

Pasi mblodhi pak vehten filloi te fliste me ngadale.

Here pas here zeri i tij dridhej nga emocioni :

- linin as te te perqafoja.
- Arrita vetem t'u thosha:
- Mari, Deni, kam frike se nuk do tju shoh me. Shpejtoni, largohuni nga keto hije qe shpirtin do tua thajnesimua. Largohuni nga ky vend. Beje ketepër hir te Denit Marie.
- Do tju ndihmoje im vella Van Deli. Ai ndodhet ne France. Ai di gjithshka. Lidhu me te.
- Roja e burgut u afrua me te shpejte. Orari i takimit kishte mbaruar.
- Qe prej atij takimi une nuk u pashe me as gruan as ty biri im.
- Nuk e di c'u be me ju. Ku shkuat, ku vajtet? Vetem nje shprese me mbante, besoja se Maria e kish kryer porosine time. Por ja me ne fund ti u ktheve “
- Deni rrinte si i ngrire, pa mundur te pergjigjej. Ne nje moment ai pasi mblodhi vehten i u drejtua te jatit me nje ze te ngasheryer:
- Baba!, tani me kujtohet... po me kujtohet si ndodhi... Rozi rrinte prane Denit e cuditur. Ajo e kishte thene qe ne fillim qe ky ishte nje vend i magjishem. Kishte ndodhur mrekullia vete. Denit i ishte kthyer kujtesa. Historia e te jatit e kishte mallengjyer si asgje tjeter. Ajo donte te dinte te verteten e plote si dhe i jati i tij.
- Fol, bir!, i u lut i jati,
- Fol Deni, i lutej Rozi.

"Isha cilesuar kriminel, ndonese duarte nuk i kisha perlyer me gjak. C'padrejttesi!. Trupin e kisha te mpire nga lodhja, kembet e drobitura, syte e skuqur dhe shpirtin e plagosur . Akoma ne veshet e mij ndjehen uleimat e tyre:

-Kriminel!, guxo e kundershito!... Mosharro se ke grua dhe femije.

Une rrija i heshtur me syte e nje fajtori qe s'ka bere faj. Enderroja per asgje. Here here cmendua me pushtonte kur numuroja ditet qe kalonin. Me hypte deshira per te vrare vehten. Por deshira per jeten ishte me e forte. Mendoja dhe iu trembesha mendimeve te mija. I vetmi shqetesim ishte per gruan dhe femijet.

Kisha frike se mos i ndeshkonin. Kisha humbur sensin e kohes. Vetem dija te numeroja. Vetem kaq.

Nje dite erdhi per te me pare nenajote bir. Shkova ne takim i drobitur, i lenuar, pa deshire jete, pa fuqi mes atij tuneli te zymte e te thelle. Ecja dhe degjoja zhurmen e perplasjes se kangjellave. Pastyere pashe fytyren e neves tende dhe tenden.

Ajo dridhej, i mbante lotet, por buzet e saj dicka kerkonin te me thoshnin. Ishte dobesuar shume, ishte bere edhe ajo pa jete. Ty bir te shterngonte forte. Ti ishe e vetmja shprese per te. Ne te dy te veshtronim ty dhe s'flisnim, por qanim pa ze. Ti rrije i cuditur dhe une te veshtroja me cmenduri se kanbgjellat nuk me

Lutja kumboi ne te tera anet e dhomes.

Deni mbeshteti koken tek kraharori i te jatit dhe syte gjysem te mbyllur nisi te tregoje historine e fshehur ne kujtesen e tij.

“Isha i vogel atehere dhe nuk i dija veshtiresite, qe do te na dilnin perpara. Porosia e babait me kishte frikesuar, ndoshta nga ato kangjella te hekurta. Por nena ishte shume me e forte. Me kujtohet se kishte sy te zinj dhe floke te gjate deri tek mesi. Bukuria e saj cdo dite venitej si lulja qe fyshket dalengadale.

Me kujtohet mire ajo dite. Ishte e diele. Nena sillej me me shume dashuri se heret e tjera me mua dhe Dukej shume frikesuar. Ecte me te shpejte neper shtepi, ulej e ngrihej here pas here.

Papritur, me terhoqi prane vehtes dher me tha:

-Duhet te kalojme kufirin! .Sot ne mesnate. Matane kufirit te pret xhaxhi jot, Deni.

Vendosmeria e saj me frikesoi. Per nje cast mbeta si i ngrire me syte ne tavan. Trupin ma pershkoi nje afsh i xehte. Kisha frike. E kuptohja se po kalonim kufirin ne menyre te parregullte. Po te deshtonim na priste vdekja ose burgu, atje ku kalbej babai im.

Vendosa te ndiqja nenen. Ishim ne Valbone. Dielli ishte ne te perenduar. Dukes se ai po largohej per te mos e pare ate skene te frikshme.

Ecnim me ato kepuce qe nuk e perballonin rrugen e pazakonte. Shkelnim mbi ferra dhe shkurre, te shoqeruar here pas here me ndonje angullitje qeni, qe vinta nga larg.

Mendja thoshte :

-Ecni!

Ndersa shpirti :

-Mos!

E si mund te largoheshe aq kollaJ nga vendi ku ishim rritur. Na Dukej sikur duke lene kete toke, linim nje pjese te shpirtit tone, nje pjese te zemres sone.

Nena me shterngonte forte dhe ecte me mxitim. Dukej sikur cdo gje na pergjonte.

Pas pak u gjendem perballe nje mali te larte e te zymte, majas e te cilit priste barkun e qiellit. Pemet ishin te rralla, ndersa shkuret po beheshin me te shumta. Kishim rene ne duarte e fatit dhe fati na kishte nxjerre peerpara nje pengese te pamposhtur: malin e Kolates dhe afer tij ate te Zgalemit, te cilet duke u perfqafuar me njeri tjetrin formonin nje qafe te gjere. Duhej ti ngjiteshim asaj qafe. Udhetimi po veshitresohej. Nena vetem thoshte:

-Ec bir ! se dhe pak do te arrijme.

Nata filloi te behej me e erret. Dukej se ajo se bashku me ashpersine e atyre maleve kerkonte te na ndihmonte. Ishim futur ne labirinthin e erresires. Ne

nje moment u degjua zeri i ulet i nenes:

-Kujdes bir, perpara eshte nje humnere, mos bej zhurme, ketu cdo gje pergjon !,

Kishim ecur shume dhjetra metra, pa e ditur se poshte muD te na priste vdekja. Nje ha i gabuar, nje shikim i mjegulluar dhe jeta jone perfundonte poshte asaj humnere.

Kembet toa renkonin kur rreshqisnim papritur. por zemra rrihte forte. Fati po luante me ne sic luan elefanti me dy miza.

Pas nje gjysem ore filluam ti ngadalsonim hapat, degjohej vetem frymemarrja e jone. Humnera kishte mbetur prapa. Ende mbaheshim ne kembe. Ishim gjysem te mpire, por ende leviznim me sforcim. Nuk e kuptova as vete sesi kaluam, vetem zeri i nenes me kujtohet, kur ajo me syte plot lote me tha:

-E kaluam bir, dhe me shterngoi tere force pas vetes se saj.

Po agonte. Edhe nata ndihej e gezuar. Ajo po shkonte te flinte e qete. Kurse dielli po ngrihej per te na treguar rrugen e re.

Kur ishim ulur per tu clodhur, degjuam nje bori makine. Ishter xhaxhai, Van Deliu, qepo na priste. Ai na perqafoi dhe s'po u besonte syve.

Zemrat tona rrihnin ngadale, tashme te qetas dhe shpirtrat tonba u qetesuan pak. Kishim mposhtur

vdekjen. Une ndihesha i gezuar , kurse nena ishte e trishtuar.

Hypem ne makine, dhe xhaxhai i dha me te reshpejtesine e mundshme. Deri tani fati na kishte ndihmuar. Por a do te na ndihmonte edhe me tej?

Ne shpresonim shume tek ai, po ai jo tek ne.

Keshtu udhetuam per nje kohe te gjate. Me kujtohet qe ndaleshim per te fjetur ne disa motele anes rruges. ndersa ditën udhetonim pa pushim , vec kohes qe na duhej per te ngrene. Koha kish filluar te loste mene. Pa pritur nje send i sternadh na doli perpara. Ndjeva nje dhimbje te madhe ne koke, cdo gje mu rrotullua dge nuk mbaJ me mend asgje. Kishim pesuar aksident. Fati kishte luajtur me jeten tone si luani me prehen e tij.

Me vone , sic e dini tashme , u ndodha ne nje spital . ne France.

Vetem une kisha shpetuar. Tani jam ne gjendje te kujtoj gjithshka”.

Rozi fshiu syte dhe pa trupin e Denit qe u perplas ne krevat.

Deni zgjati doren drejt te jatit dhe ai ia shterngoi forte.

Toka u cel, dielli ndricoi , gurgullima Valbones u forcua, dhe nje rreze e vogel u perplas ne syte e Denit.

Natyra ishte deshmitare e nje historie te dhimbshme dhe degjonte ne heshtje melodine e saj.

